МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА - БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS - BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE - BUREAU FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION

Udhëzues për metodikën e mësimit në distancë në shkollën fillore dhe të mesme

Ky dokument është përpiluar nga grupi punues i formuar në kuadër të projektit të USAID-it për Integrim Ndëretnik të të Rinjëve në Arsim të implementuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ), në bashkëpunim me Byronë për Zhvillimin e Arsimit me mbështetje nga populli amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e dokumentit nuk i shprehë qëndrimet e Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përmbajtja

Hyrje 3
1. Përgatitje për mësim në distancë 3
2. Planifikim i mësimit në distancë 4
3. Përgatitje për realizimin e orës mësimore dhe sigurim të materialeve për mësim dhe nxënie 4
4. Funksionalitete të PKMD-së dhe mënyra të përdorimit funksion të metodikës së mësimit 5
5. Realizimi i orës cilësore në distancë 9
A. Struktura e orës 10
B. Forma dhe metoda të nxënies dhe mësimdhënies në mësimin në distancë 14
C. Vëzhgim, vlerësim dhe notim i mësimit në distancë 24
D. Orë të përbashkëta në distancë 28
6. Nxitje të interesit dhe mirëmbajtjes së motivimit për nxënie 30
7. Përkujdesje për aspektet socio-emocionale të nxënies 31
Shembuj 34

Hyrje

Mësimi në distancë zhvillohet në një mjedis të ri ku rol themelor ka teknologjia. Digjitalizimi është pjesë e pashmangshme e procesit të nxënies në distancë dhe ai në masë të madhe e determinon arritjen e qëllimeve dhe rezultateve nga nxënia. Mësimdhënësi në mësimin në distancë, para së gjithash, është mentor (mbështetës, udhëzues), ndërsa vetëm herë pas herë ligjërues.

Përdorimi i teknologjisë digjitale në mësim, ofron fleksibilitet më të madh në mësimdhënien dhe nxënien (veçanërisht nëse përdoret në kombinim me mësimin me prani fizike), por kërkon edhe përgatitje më të madhe nga mësimdhënësi.

Për shkak të faktit që nxënia në distancë nënkupton përshtatjen e pedagogjisë dhe metodikës së mësimit, është me rëndësi që mësimdhënësit të përsosen gradualisht, të eksperimentojnë, por edhe të jenë të hapur për mësim nga tentimet dhe gabimet personale. Është me rëndësi të bashkëpunojnë mes vete dhe të shkëmbejnë përvoja, me qëllim të përmirësimit të mësimit dhe përsosjes së kompetencave personale. Bashkëpunimi dhe mbështetja në nivel të kolektiveve shkollore dhe kolektiveve të mësimdhënësve të lëndëve të përafërta, me kalimin e kohës duhet të rezultojë me avancimin e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe rritjen e vetëbesimit për përdorimin e qasjeve të ndryshme gjatë nxënies në distancë.

Udhëzimet që vijojnë kanë për qëllim të ofrojnë përshkrim të veglave, qasjeve, metodave dhe formave të ndryshme që mund të përdoren gjatë mësimit në distancë. Qëllimi themelor i Udhëzuesit është t'i frymëzojë dhe nxitë mësimdhënësit të provojnë vegla dhe metoda që konsiderojnë se janë përkatëse për realizimin e mësimit në klasën e tyre virtuale, e gjithë kjo në përputhje me shkathtësitë e tyre personale, por edhe shkathtësitë e nxënësve. Pritet që Udhëzuesi të përsoset dhe të avancohet në bazë të përvojave praktike të mësimdhënësve dhe kreativitetit të tyre në realizimin e mësimit që është në interesin më të mirë të nxënësve.

1. Përgatitje për mësim në distancë

Përgatitja e mësimit në distancë përfshin:

- sigurimin e pajisjes përkatëse teknike dhe instalimin e veglave të nevojshme dhe mirëmbajtjen e tyre;
- përcaktimin e veglave përkatëse digjitale didaktike (të përshkruara më poshtë) që do të përdoren për realizimin e temave/fushave/njësive të caktuara mësimore nga programi mësimor;
- analizë, përzgjedhje, përdorim dhe krijim të resurseve dhe materialeve përkatëse digjitale;
- përcaktimin e qasjes, formave dhe teknikave metodike për arritjen e rezultateve, që mund të realizohen gjatë mësimit në distancë;
- përcaktimin e përmbajtjeve ose grupit të përmbajtjeve që mund të punohen përmes projekteve më afatgjata ose afatshkurtra ose me dinamikë individuale,
- përcaktimin e kritereve dhe instrumenteve përkatëse për kontrollimin e realizimit të qëllimeve dhe rezultateve të vendosura nga nxënia që janë përkatëse me nxënien në distancë;
- përcaktim të metodave, teknikave dhe instrumenteve për vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

2. Planifikim i mësimit në distancë

Planifikimi i mësimit paraqet proces kreativ që përfshin një varg procedurash, masash dhe aktivitetesh vijuese në mënyrë që me kohë, me cilësi dhe tërësisht të arrihen qëllimet e definuara, rezultatet nga nxënia dhe termet e përcaktuara për përmbajtjet programore në të gjitha temat/fushat programore. Planifikimi i mësimit duhet të përkoj me kushtet që të realizohet në mënyrë përkatëse. Mësimi në distancë nënkupton planifikim më të hollësishëm të aktiviteteve që duhet të realizohen para, gjatë dhe pas orës, si dhe përgatitje me kohë të materialeve mësimore dhe didaktike.

Varësisht nga qëllimi, rezultatet e nxënies dhe kohës kur duam t'i arrijmë, planifikimi i mësimit mund të jetë:

- planifikim vjetor,
- planifikim i procesit zhvillimor / planifikimi i njësisë modulare
- planifikimi i orës mësimore.

Llojet e planifikimit gjatë mësimit në distancë nuk ndryshojnë, por u përshtaten kushteve. Në mësimin në distancë përgatitja për mësim përqendrohet në harmonizimin e përmbajtjeve nga programi mësimor me resurset digjitale në dispozicion, përzgjedhjen e veglave dhe formave përkatëse për punë, si dhe organizim të mësimit.

3. Përgatitje për realizimin e orës mësimore dhe sigurim të materialeve për mësim dhe nxënie

Ora mësimore në mësimin në distancë siguron marrjen e informacioneve themelore, mentorimin dhe udhëzimin në procesin e përvetësimit të diturive, shkathtësive dhe kompetencave. Në këtë njësi kohore të procesit mësimor, mësimdhënësi duhet:

- të sinkronizojë qëllimet e përgjithshme dhe specifike dhe të sigurojë arritjen e tyre me veglat dhe mundësitë teknike digjitale në dispozicion;
- të sigurojë ndarje të përmbajtjeve në: (1) dituri thelbësore/parime dhe procese themelore, (2) dituri plotësuese/informacione më të hollësishme që janë të dobishme por jo edhe të detyrueshme dhe (3) dituri të specializuar/detaje për problematikën;
- të sigurojë udhëheqje të procesit të nxënies në nivel (mësimdhënës – përmbajtje – nxënës – prind – teknologji);
- të ndajë kohë për njoftim me të gjitha funksionalitetet relevante të veglave dhe të ketë përgatitur alternativa nëse një vegël e caktuar nuk punon gjatë orës;
- të përdorë metoda dhe forma që mundësojnë nxënësit të kenë pjesëmarrje aktive gjatë orës dhe të përvetësojnë dituri, shkathtësi dhe kompetenca të përhershme funksionale;
- të mbajë llogari që të gjitha resurset që i përdorë të jenë të kontrolluara dhe të sigurta nga aspekti i mbrojtjes së të dhënave personale të mësimdhënësit dhe të nxënësve.

Mënyra e ndarjes dhe dhënies së materialeve, rregullsia dhe sistematike e materialeve nga mësimdhënësit, ndikojnë në dëshirën për absorbimin e diturive të reja te nxënësi. Seleksionimi i mirë dhe renditja sipas radhës është faktor që ndikon në nxitjen e nxënësve. Duhet të merret parasysh si vijon:

- Të përgatiten udhëzime për nxënësit: cilat vegla digjitale do të përdoren, ku mund të gjenden materiale të caktuara, si bëhet qasja, si bashkëngjiten materialet, etj. Udhëzimet do të varen nga natyra e lëndës, mosha e nxënësve dhe kompetencat e tyre digjitale;
- secili material shënohet me: datë titull, temë/modul[1];
- materialet ose resurset për nxënie organizohen në dosje elektronike, ndërsa struktura duhet t'i ndjekë njësitë modulare/tërësitë tematike;
- materialet ose resurset që kanë dedikim përvetësimin e diturisë plotësuese dhe të specializuar, duhet të shënohen në mënyrë përkatëse në titujt;
- qasja deri te materialet nga interneti duhet të jetë e shkruar në mënyrë të saktë ose link i kopjuar në mënyrë që të hapet me „klik";
- sipas mundësisë, përzgjidhen resurse formate që nuk kërkojnë instalim plotësues, regjistrim të përdoruesit, etj.;
- platforma kombëtare për nxënie në distancë është zonë e mbyllur në të cilën informacionet që dorëzohen janë të sigurta dhe të mbrojtura, gjë që nuk është gjithmonë rast me veglat dhe resurset digjitale që mund të përdoren, por janë jashtë platformës.

4. Funksionalitete të PKMD-së dhe mënyra të përdorimit funksion të metodikës së mësimit

Përdorimi i Platformës kombëtare për nxënie në distancë mundëson nxënie në distancë, gjegjësisht kombinim të komunikimit sinkron dhe asinkron. Të gjitha aktivitetet realizohen përmes Platformës kombëtare ku komunikimi sinkron është parashikuar të realizohet përmes Microsoft Teams që është pjesë e Platformës kombëtare.

Gjatë krijimit të përmbajtjeve të Platformës kombëtare për nxënie në distancë mund të shtohen aktivitete ose resurse të ndryshme. Në vazhdim janë aktivitetet ose resurset e përdorura më shpesh, me përshkrim të mënyrave në të cilat mësimdhënësit mund t'i përdorin gjatë realizimit të mësimit.



Foto 1. Aktivitete dhe resurse

[1] „Modul" është një njësi e pavarur për nxënie që paraqet tërësi të rrumbullakuar ose pjesë të programit arsimor. Ky përkufizim është në përputhje me përkufizimin nga Ligji për KKK-në (kornizë kombëtare e kualifikimeve (2013).

Aktivitete të përdorura më shpesh:

Aktiviteti **mësim** i mundëson mësimdhënësit të realizojë përmbajtjen në mënyrë interesante dhe fleksibile, duke krijuar në varg linear të faqeve ose aktiviteteve përmbajtësore për pjesëmarrësit. Mësimdhënësi mund të përzgjedhë nëse përmbajtja do të përfshijë pjesën tekstuale, audio/video shënime, pyetje dhe ngjashëm. Gjatë parashtrimit të pyetjeve, varësisht nga përgjigjja e përzgjedhur e nxënësit dhe mënyra në të cilën mësimdhënësi e zhvillon mësimin, nxënësit mund të kalojnë drejt faqes së radhës, të kthehen në atë paraprake, ose të ridërgohen në shteg tërësisht të ndryshëm. Mësimi mund të notohet me shënimin e notës në ditarin për nota. Mësimi mund të përdoret për: përvetësimin e përmbajtjes së re mësimore, nxënie të mëvetësishme të orientuar, ushtrime, përsëritje, etj. Më shumë për këtë aktivitet mund të shikoni në këtë video.

Detyra e shtëpisë si aktivitet i mundëson mësimdhënësit të japë detyra të shtëpisë, t'i mbledhë detyrat e përpunuara nga nxënësit dhe më pas t'i notojë të njëjtat, me notë dhe/ose informacione kthyese. Me këtë rast, nxënësit mund të dorëzojnë çfarëdo përmbajtje digjitale (skedar), ose të vendosin tekst drejtpërdrejt në rregulluesin e tekstit. Ekzistojnë edhe rregullime plotësuese si mënyrë e parashtrimit (individuale ose grupore), qasje e detyrës së shtëpisë, mënyrë e notimit dhe ngjashëm. Nëse detyra e shtëpisë notohet me notë e njëjta do të paraqitet në ditarin për nota. Mënyra e dhënies së detyrës së shtëpisë është sqaruar në këtë video.

Aktiviteti i **kuisit** i mundëson mësimdhënësit të krijojë kuise për nxënësit. Pyetjet në kuisin mund të jenë të ndryshme: zgjedhje e shumëfishtë, e vërtetë/e gabuar, lidhje, përgjigje e shkurtër, pyetje ese, deri plotësim. Mësimdhënësi mund të krijojë kuisin nga e para ose të përdorë pyetje nga baza e të dhënave që ka krijuar paraprakisht. Me këtë rast ekzistojnë edhe kurdisje shtesë si radhitja e pyetjeve, koha e zgjidhjes, mënyra e notimit dhe ngjashëm. Përve pyetjeve të hapura (ese), vlerësimi i të gjitha pyetjeve të tjera bëhet automatikisht. Kuiset mund të përdoren: për të kontrolluar arritjen e qëllimeve mësimore në fund të orës, për të përcaktuar njohuritë paraprake të nxënësve për një temë të caktuar, siç janë ushtrimet, për t'i dhënë informacion të shpejtë kthyes nxënësit , për vetënotim, etj. Më shumë për mënyrën e përdorimit të këtij aktiviteti mund të shikoni në videot si vijon: https://youtu.be/QQmi09gUAps dhe https://youtu.be/jFZsXGLMjvY

Aktiviteti **informacion kthyes** i mundëson mësimdhënësit të krijojë anketa personale për grumbullimin e informacioneve kthyese nga pjesëmarrësit duke përdorur lloje të ndryshme të pyetjeve duke përfshirë përzgjedhje të shumëfishtë, po/jo pyetje ose pyetje tekstuale. Përgjigjet mund të jenë edhe anonime, ndërsa rezultatet mund t'u paraqiten të gjithë pjesëmarrësve ose të kufizuara vetëm për mësimdhënësit. Këto aktivitete mund të përdoren për: identifikimin e njohurive paraprake të nxënësve, marrjen e informacionit kthyes gjatë ose pas përfundimit të orës. Mënyra e përdorimit të këtij aktiviteti është sqaruar në këtë video.

Përzgjedhja e aktivitetit që i mundëson mësimdhënësit të parashtrojë një pyetje dhe të kërkojë përgjigje nga nxënësit për të njëjtën. Rezultatet nga përzgjedhja mund të publikohen pasi që nxënësit të përgjigjen, pas një date të caktuar, ose të mos publikohen fare. Ky aktivitet mund të përdoret kur mësimdhënësi ka nevojë për grumbullimin e shpejtë të informacioneve nga nxënësit, për shembull pyetje të shkurtër për kontrollimin e të kuptuarit, gjatë orës në distancë.

Mësimdhënësit gjatë krijimit të përmbajtjeve të tyre mund të shfrytëzojnë edhe instrumente të verifikuara për anketim që janë dëshmuar si të dobishme për vlerësimin dhe stimulimin e nxënies onlajn, duke shfrytëzuar aktivitetin **pyetësor**. Këto vegla përdorin

pyetje të parashtruara paraprakisht, e nëse mësimdhënësi dëshiron të bëjë pyetësor personal duhet ta përdorë aktivitetin informacion kthyes.

Aktiviteti **forum** u mundëson pjesëmarrësve të udhëheqin diskutim asinkron gjegjësisht të diskutojnë në periudhë të vazhduar kohore. Ekzistojnë më shumë lloje të forumit që mund të përzgjidhen, si forum standard ku secili mund të fillojë diskutim në çfarëdo kohe; ose forum me pyetje dhe përgjigje ku nxënësit duhet doemos së pari të publikojnë diçka para se të mund t'i shikojnë përgjigjet e nxënësve të tjerë. Publikimet në forumin mund të jenë të vlerësuara nga mësimdhënësit ose bashkënxënësit. Forumi mund të përdoret për: komunikim dhe bashkëpunim më të mirë mes nxënësve përmes shkëmbimit të mendimeve dhe ideve, ndarjen e informacioneve të dobishme, diskutim për përmbajtjet e lëndës ose materialet e parashtruara në mënyrë plotësuese, mbështetje mes mësimdhënësit dhe nxënësve gjatë punës, pyetje me nivel të ndryshëm të kompleksitetit, përpunim të problemeve që nxisin nivele më të larta të të menduarit.

Përmes **MS Teams** mësimdhënësit mund të caktojë orë me nxënësit ose nga ana tjetër takim për ndonjë aktivitet plotësues. Udhëzim të hollësishëm për përdorimin e MS Teams mund të shikoni në këtë link.

Resurset e përdorura më shpesh:

Përmes resursit URL mësimdhënësi mund të vendosë link deri te ndonjë resurs onlajn (foto, audio/video shënim, ueb faqe etj). Me këtë rast, përmbajtja mund të jetë vetë faqja ose të hapet në dritare të re dhe opsione plotësuese për bartjen e informacioneve, si për shembull emri i nxënësit, nëse është i nevojshëm. Më shumë për mënyrën e përdorimit të këtij resursi mund të gjeni në këtë video. Duhet doemos të merret parasysh se URL-ja gjithashtu mund të shtohet edhe në cilindo resurs ose aktivitet tjetër përmes rregulluesit të tekstit.

Mësimdhënësi si pjesë të përmbajtjeve mund të bashkëngjitë çfarëdo lloji të skedarit duke përdorur resursin **skedar**. Nxënësit mund ta shikojnë onlajn ose ta lëshojnë në aparatet e tyre. Procedura për bashkëngjitjen e skedarit është paraqitur në këtë video.

Etiketa (fleta ngjitëse) është resurs që mundëson përfshirjen e tekstit dhe multimediale në faqet për lëndën mes lidhjeve deri te resurset dhe aktivitetet tjera, duke kontribuar për pamjen më të mirë të faqes. Mund të përdoren për: ndarjen e përmbajtjeve më të gjata, vendosjen e përshkrimit të shkurtër, vendosjen e fotove dhe ngjashëm. Mënyra e shtimit të etiketës është përshkruar në këtë video.

Faqja është resurs që i mundëson mësimdhënësit të krijoj ueb-faqe duke përdorur rregulluesin për tekst. Faqja mund të paraqesë tekst, foto, tingull, video, linqe, etj. Përparësia e përdorimit të modulit faqe përballë modulit skedarë është që ky resurs është më i kapshëm (për shembull, për shfrytëzuesit e aparateve celulare) dhe është më i thjeshtë për t'u azhurnuar. Moduli faqe mund të përdoret për: prezantimin e përmbajtjet mësimore që përmban lloje të ndryshme të të dhënave. Më shumë për mënyrën e krijimit dhe rregullimit të saj mund të shikoni në këtë video.

Për sasi të mëdha të përmbajtjes, rekomandohet të përdoret resursi **libër** në vend të modulit faqe. Ky resurs është i përbërë prej më shumë faqeve në formë të librit me kapituj dhe nënkapituj. Librat mund të përmbajnë skedarë mediatik si dhe tekste dhe janë të dobishme për paraqitjen e pasuseve më të gjata që mund të ndahen në seksione. Më shumë për resursin libër mund të shikoni në këtë video.



Foto 2. Resurs: Libër

Më shumë për mundësitë e Platformës për nxënie në distancë dhe mënyrën e përdorimit të saj mund të lexoni në linkun si vijon:
https://www.youtube.com/watch?v=1cREehmdBv4&t=1020s

OneDrive paraqet hapësirë për vendosjen e të gjithë dokumenteve tona. Duke përdorur OneDrive keni qasje deri te ato në çfarëdo kohe, nga çfarëdo vendi dhe në çfarëdo aparati. Të njëjtat mund të ndahen me mësimdhënësit dhe nxënësit tjerë, gjë që mundëson punë të përbashkët për ta, duke nxitur komunikim, bashkëpunim, shkëmbim të ideve dhe krijim të përbashkët të produkteve finale gjatë mësimit.

Më shumë për mënyrën e përdorimit të OneDrive mund të gjeni në linkun si vijon:https://www.youtube.com/watch?v=LkepqUbVXlQ

Punë në grupe. Ndarja në grupe gjatë komunikimit të sinkronizuar mund të realizohet përmes krijimit të grupeve në kuadër të një ekipi. Duke përdorur opsionin Breakout rooms në MS TEAMS (vetëm në versionin Desktop) mësimdhënësit mund t'i ndajnë nxënësit e paraleles në grupe dhe më pas nxënësit në kuadër të secilit grup mund të komunikojnë, bashkëpunojnë, po madje edhe të punojnë bashkërisht në ndonjë projekt. Në secilin grup mund të realizohet një video takim i posaçëm mes nxënësve në grup, ndërsa mësimdhënësi të hyjë dhe të dalë prej tyre. Në një ekip mund të realizohen në mënyrë simultane më shumë video takime, dhe nxënësit të kthehen në takimin e përbashkët kur do të ketë nevojë për këtë. Udhëzimi për krijimin e grupeve (në anglisht) është i kapshëm në linkun si vijon: https://www.youtube.com/watch?v=DMfsilBhW7A

Në mënyrë alternative, nëse mësimdhënësi vlerëson se gjatë orës nuk ka kohë të mjaftueshme për shpërndarje nëpër kanale (grupe) dhe kthimi i sërishëm në sesion plenar, mund të caktojë takime të veçanta për grupe të ndryshme dhe ato të punojnë në grup gjatë tërë orës. Ndarja në grupe është mirë të bëhet dhe paralajmërohet para orës, ndërsa prezantimi i punës në grup të zhvillohet gjatë orës së posaçme, ku gjithë klasa/paralelja do të jetë së bashku.

Tabela onlajn (Whiteboard) paraqet vegël përmes të cilës mund të imitohet në mënyrë virtuale përvoja nga shkrimi në tabelë në klasë fizike. Vegla e këtillë është e kapshme në platformën Microsoft Teams. Këto tabela ofrojnë një pëlhurë të pafundme për shkrim,

skicim, mund të vendosen foto, të përdoren formularë të përgatitur paraprakisht, në to mund të krijohen diagrame, grafikone, tekste të ndryshme, etj.

Për dallim nga tabelat tradicionale, ato gjithashtu mundësojnë digjitalizim të përmbajtjes së krijuar dhe lejojnë shkëmbimin e sërishëm dhe thirrjen e tyre më vonë. Në tabelat onlajn bashkë me mësimdhënësin mund të punojnë edhe nxënësit, gjegjësisht të bashkëpunojnë në pëlhurën e njëjtë në të njëjtën kohë (përmes opsionit annotate). Kështu nxënësve mund t'u jepet të bëjnë dhe shkruajnë detyra në tabelë, të shënohen propozimet dhe idetë që rezultojnë nga teknika stuhi e ideve, mund të vizatohen harta, diagrame, teknika e rrushit. Gjithashtu, mund të bëhet dokument me kuis që do të vendoset në tabelën dhe nxënësit do të mund ta zgjidhin në mënyrë bashkëvepruese në kohë reale. Më së miri është që, bashkë me nxënësit, të hulumtohen dhe provohen opsionet që i ofron tabela, në mënyrë që të zbatohet ajo që më së shumti përputhet me lëndën mësimore dhe qëllimet konkrete të orës.

Biseda (chat/koment) onlajn është edhe një mënyrë e shkëlqyeshme për të marrë pjesë dhe replikuar në diskutimet që zhvillohen në kohë reale gjatë orës. Microsoft teams si platformë që përdoret për mbajtjen e orëve në kohë reale e ka këtë opsion/vegël. Krahas përdorimit të saj si vegël për ndarjen e informacioneve lidhur me orën, mund të përdoret edhe për diskutim për një temë të caktuar (si ndërlidhje të komunikimit zanor), për zbatimin e stuhisë së ideve, për dhënien e informacionit kthyes individual ose grupor, për parashtrimin e pyetjeve lidhur me përmbajtjen (pa e ndërprerë mësimdhënësin ose bashkënxënësin), reflektim të shkurtër për atë që është mësuar përmes fjalës ose fjalisë, etj. Vetë biseda me shkrim në "koment" mund t'u sigurojë nxënësve informacione që do t'i përdorin gjatë përpunimit të detyrave të shtëpisë ose gjatë përgatitjes së testeve dhe kontrollimit dhe notimit të diturisë. Në mënyrë që vegla të përdoret në mënyrë përkatëse, është me rëndësi që të vendosen udhëzime publike dhe të sigurohet mundësi e barabartë për të gjithë nxënësit që t'i publikojnë idetë e tyre dhe t'i vendosin pyetjet e tyre. Kjo mund të bëhet përmes parashtrimit të rregullave të sjelljes: ngritjen e dorës në mënyrë që të merret fjala, shkrimi në „koment" nëse nuk ka kohë që të parashtrohen të gjitha pyetjet, me atë që mësimdhënësi do t'ua dërgojë përgjigjet në këto pyetje të gjithë nxënësve në mënyrë plotësuese.

5. Realizimi i orës cilësore në distancë

Në mënyrë që të mund të realizohet orë e suksesshme mësimore onlajn nevojitet që **para orës** mësimdhënësi të:

- ketë konfirmim se të gjithë nxënësit kanë shtrirje teknike dhe vegla të nevojshme të instaluara dhe qëndrueshmërinë e tyre;
- dërgojë/sigurojë paraprakisht për nxënësit materialin e nevojshëm, në mënyrë që të minimizojë kohën për lexim ose ligjërim gjatë orës, e këtë ta zëvendësojë me diskutim, sqarim dhe konstatime për gjërat e rëndësishme;

Sigurimi i materialeve dhe veglave përkatëse është një nga elementet kyçe për realizimin e suksesshëm të orës në distancë. Kjo parashikon përdorimin e (disa prej) materialeve si vijon:

- përgatitje të prezantimit me poentat kryesore në slajd;
- sigurimin e shembujve të situatave reale ose hipotetike ose studimeve të rastit;
- përdorim të infografikëve, fotove dhe afisheve për ilustrim;
- sqarim në video shënim të shkurtër YouTube/TedTalk/video interesante për përmbajtje hyrëse;
- sigurim të materialeve/artikujve/ueb rekomandimeve nga faqe dhe/ose informacione nga punimet dhe sesionet e shkurtra për nxënie të mëvetësishme;
- përdorim ose krijim të tabelës ose fletës së bardhë për ilustrim të drejtpërdrejt (ose funksion të tabelës të veglës);
- përpilim të videos që përdoret për hyrje, demonstrim, eksperiment dhe ngjashëm.
- Përdorim të videove të vendosura në Platformën Eduino: http://www.eduino.gov.mk/

A. Struktura e orës

Në përputhje me udhëzimet didaktike për realizimin e mësimit në distancë, të përpiluara nga BZHA-ja, ora mësimore në arsimin fillor (në mësimin klasor dhe lëndor) është parashikuar të realizohet në kohëzgjatje prej 30 minutave, ndërsa në arsimin e mesëm i njëjti duhet të zgjasë 35 minuta. Me këtë rast në të dyja rastet pjesa hyrëse e orës zgjatë rreth 5 minuta, pjesa përfundimtare 5-10 minuta, ndërsa për pjesën kryesore të orës janë parashikuar 15 – 20 minuta në arsimin fillor, dhe 20 – 25 minuta në arsimin e mesëm[2]. Për realizimin e mësimit onlajn është bërë e ditur që të përdoren e-përmbajtje më të ndryshme që do të mundësonin bashkëveprim dhe përfshirje aktive të nxënësve gjatë realizimit të mësimit në distancë, përmes të cilës do të siguronin efektivitet në mësim.

Me këtë rast, është me rëndësi të përmendet se mësimi onlajn nuk ka të bëjë vetëm me realizimin e orës në distancë, gjegjësisht nuk e përfshin vetëm komunikimin sinkron[3], derisa zgjatë vetë ora, por edhe një numër të madh të aktiviteteve para fillimit të orës dhe aktiviteteve pas përfundimit të orës, si pjesë e komunikimit asinkron[4]. Sipas kësaj, në aspektin kronologjik, mësimi onlajn mund të prezantohet si ndërlidhje të pjesës asinkrone (para orës në distancë), pjesës sinkrone (orës në distancë) dhe pjesës asinkrone (pas orës në distancë). Përfaqësimi i secilës prej këtyre tri pjesëve në mësimin onlajn do të varet para së gjithash nga mosha e nxënësve, aftësimi i tyre për përdorimin e teknologjisë, si dhe mënyra e realizimit të mësimit para se të kalohet në mësimin onlajn. Nuk pritet që secila orë të jetë e realizuar në këtë mënyrë, por është e pritshme që me rritjen e moshës së nxënësve të rritet edhe numri dhe lloji i resurseve dhe aktiviteteve që janë të dedikuara të realizohen në mënyrë asinkrone.

Përdorimi i **qasjes së "klasës së përmbysur"** (flipped classroom) paraqet mënyrën më të mirë për të mundësuar bashkëveprimin e nevojshëm në orë dhe nxitjen e nxënies së thelluar dhe vetëorientuar te nxënësit. Gjatë kësaj qasjeje, nxënësit realizojnë në mënyrë të mëvetësishme disa aktivitete të caktuara që kanë të bëjnë me temën e orës mësimore, para se të fillojë komunikimi sinkron (orë në distancë), që më pas do të përdoren gjatë orës për diskutim dhe përfshirje më të madhe aktive të nxënësve gjatë orës. Varësisht nga mosha e nxënësve, mësimdhënësi duhet të planifikojë nëse dhe sa aktivitete asinkrone do

[2] https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/Upatstvo_za_realizacija_na_skratenite_programi-alb.pdf
[3] Gjatë komunikimit sinkron, mësimdhënësi dhe nxënësit janë të pranishëm në vendin e njëjtë në të njëjtën kohë dhe mund të komunikojnë në kohë reale.
[4] Gjatë komunikimit asinkron, mësimdhënësi dhe nxënësit nuk është e domosdoshme që të jenë njëherësh në vend të njëjtë, por nxënësi mund të punojë në detyrat e dhëna nga mësimdhënësi, në kohën që i përshtatet atij, ndërsa komunikimi mund të zhvillohet përmes: dhënies së komenteve në tekste, forume për diskutim, etj.

t'u japë nxënësve para dhe pas orës në distancë dhe si do t'i ndërlidhë me aktivitetet sinkrone gjatë orës.

Duhet theksuar se një numër i madh i aktiviteteve mund të përputhen, gjegjësisht një aktivitet i njëjtë mund të jetë i dhënë si aktivitet para orës, ose gjatë pjesës hyrëse të orës, ose nga ana tjetër si aktivitet pas orës, ose gjatë pjesës përfundimtare të orës. Përzgjedhja e aktivitetit dhe shpërndarja e tyre do të varet nga të gjithë faktorët e përmendur paraprakisht (mosha e nxënësve, koha në dispozicion, aftësi për përdorimin e teknologjisë, mënyrë e realizimit të orës dhe ngjashëm).

Nuk pritet që qasja e këtillë të përdoret vazhdimisht, si pjesë e secilës orës ose çdo përmbajtjeje/teme mësimore, meqë e njëjta mund të shkaktojë ngarkesë tepër të madhe të nxënësve. E njëjta duhet t'u përshtatet përmbajtjeve që përpunohen dhe rezultateve nga nxënia që duhet të arrihen. Njëherësh, nevojitet koordinim mes mësimdhënësve në mënyrë që të përshtatet niveli i angazhimit të nxënësve.

I. Para fillimit të orës (aktivitete asinkrone)

Aktivitetet që realizohen **para fillimit të orës**, duhet të përdoren si aktivitet hyrës i mëvetësishëm asinkron, për të siguruar informacione dhe njohuri të mjaftueshme te nxënësit në mënyrë që të realizohet vetë ora në distancë (aktiviteti sinkron). Zakonisht ky aktivitet nuk do të duhej t'u marrë nxënësve më shumë se 10-15 minuta (varësisht nga mosha), me atë që ata vetë mund të vendosin se kur do ta realizojnë aktivitetin e mëvetësishëm.

Disa lloje të aktiviteteve mund të realizohen para fillimit të orës që kanë të bëjnë me përmbajtjen mësimore që do të realizohet (teksti në kllapa përkon me funksionalitetet që janë të kapshme përmes platformës kombëtare për mësim në distancë):

- Lojë edukative për të cilën më tutje mund të jepet mendim (përmes linkut të jashtëm, anketës)
- Material për lexim për të cilin më pas mund të diskutohet, ose të realizohet test i shkurtër i mëvetësishëm (skedar, faqe interneti, forum, test nga banka e pyetjeve)
- Video që duhet të shikohet, dhe për të cilën duhet të diskutohet, ose të realizohet test i shkurtër i mëvetësishëm (dokument, link i jashtëm, forum, test nga banka e pyetjeve)
- Çështje e problemit ose sfidë e ndërlidhur me përmbajtjen mësimore, për të cilën më tutje mund të jepet zgjidhje (dokument, link i jashtëm, forum, anketë)
- Kuis onlajn ose anketë për vlerësimin e diturisë ekzistuese dhe të kuptuarit (përzgjedhje, kuis, pyetësor)

Të gjitha këto aktivitete i nxisin nxënësit në analizë dhe të menduarit më të hollësishëm. Pjesëmarrja në forum, anketë ose ndonjë test të shkurtër të diturive mundëson përcaktim të njohurive paraprake të nxënësve dhe qëndrimeve të tyre lidhur me përmbajtjen mësimore, ndërsa mësimdhënësit i japin bazë për planifikimin e realizimit të orës.

Ky lloj i aktiviteteve gjithashtu siguron hapësirë gjatë orës për sqarim, diskutim, parashtrim të pyetjeve me nivel të ndryshim të ndërlikimit, analizë dhe arritje të zgjidhjeve për situata të caktuara të problemit, që do të mundësojë kureshtje dhe aktivitet më të madh nga nxënësit dhe nxitje të niveleve më të larta të nxënies te nxënësit.

II. Gjatë orës (aktivitete sinkrone)

Ora në pjesën më të madhe duhet të realizohet si **aktivitet sinkron** gjegjësisht aktivitete bashkëvepruese me pjesëmarrësit, në funksion të përmbajtjes mësimore dhe qëllimeve mësimore që duhet të arrihen. Me këtë rast, duhet të evitohet prezantimi klasik ose ndarja e linqeve (videove) të jashtme, ndërsa nëse përdoret një lloj i tillë i aktiviteteve ato nuk duhet të jetë më të gjata se 30% të gjithë orës, për shembull për një orë prej 30 minutave,

koha maksimale për llojin e këtillë të aktiviteteve do të duhej të jetë 10 minuta, ndërsa pjesa tjetër e kohës t'i kushtohet bashkëveprimit të mësimdhënësit me nxënësit dhe bashkëveprimit të ndërsjellë të nxënësve.

Ora në distancë duhet të realizohet si sesion bashkëveprues, ose grup i sesioneve të parapërcaktuara nëse nxënësit duhet të ndahen në grupe, duke përdorur komunikim sinkron përmes MS Teams https://teams.microsoft.comey/. Gjatë këtij lloji të orës mund të përdoren të gjitha resurset që mësimdhënësi i ka bashkëngjitur paraprakisht në Platformën kombëtare të mësimit në distancë. Gjithashtu, mund të shfrytëzohen edhe anketa ose kuisë onlajn, të krijuar në Platformën kombëtare të mësimit në distancë, por edhe linqe të jashtme drejt disa kuisëve të krijuara paraprakisht (për shembull Kahoot, https://kahoot.com).

Pjesa hyrëse e orës në distancë shërben për njoftimin e nxënësve me qëllimet mësimore, mënyrën e arritjes së të njëjtave, si dhe nxitje të interesit të tyre dhe motivimit për pjesëmarrje aktive në të njëjtin. Theksimi i qëllimeve mësimore dhe/ose epilogëve të pritur mund të jetë i shkruar, i prezantuar me gojë ose i regjistruar si audio/video shënim. Me këtë rast mund të shfrytëzohen përmbajtjet më të ndryshme elektronike që do të nxisin kureshtjen e nxënësve dhe do t'i motivojnë për përmbajtjet që do të realizohen në orë. Aktivitete të ndryshme të lojës, anketa, citate, audio, video, problem interesant nga jeta e përditshme ose detyrë që menjëherë nxitë diskutim, mund t'i interesojë nxënësit dhe t'i sjellë në orën e mësimit. Megjithatë, për aktivitetin e këtillë duhet të planifikohen 5 minuta, me fleksibilitet shumë të vogël për vazhdim. Nëse është evidente se ndonjëri prej aktiviteteve mund të zgjasë më gjatë, në rast të tillë i njëjti duhet të shfrytëzohet si aktivitet për nxënësit para fillimit të orës, duke përdorur qasjen e "klasës së përmbysur". Për shembull, nëse është e shkurtër situata e problemit, mund të jetë hyrje e mirë në pjesën kryesore të orës, por nëse ajo përfshin zgjidhje të problemit jorutinor, për të cilin nxënësve u nevojitet kohë më e gjatë, e njëjta mund të jepet si aktivitet para orës, në mënyrë që nxënësit të kenë kohë të mjaftueshme për të menduar dhe të jenë të gatshëm që t'i ndajnë sqarimet, zgjidhjet, idetë, argumentet, qëndrimet e tyre, etj. gjatë pjesës hyrëse të orës (me gojë ose përmes anketës, forumit), që më tutje do të ishin zhvilluar më thellë përgjatë përmbajtjes së re mësimore.

Si aktivitet hyrës mund të përdoret edhe **aktiviteti "akullthyes"**, në mënyrë që të kontrollohen veglat teknologjike që do të përdoren në orë (video kamerë, mikrofon, vegël për bisedë), dhe nëse ka probleme ato të tejkalohen, si dhe të krijohet atmosferë e këndshme e punës. Aktiviteti akullthyes mund të realizohet si lojë e shkurtër ose si bisedë.

Pjesa kryesore e orës në distancë i është kushtuar arritjes së qëllimeve mësimore me nxënësit. Mënyra e realizimit do të varet nga ajo nëse nxënësit kanë pasur aktivitete që është dashur t'i realizojnë para orës. Nëse ka pasur aktivitete të tilla, pjesa kryesore e orës do të ishte realizuar përmes diskutimit me të gjithë nxënësit, ose diskutim në grupe të vogla për çështjet dhe gjetjet lidhur me aktivitetin dhe ndërlidhjen e tij me qëllimet e orës. Nëse për njoftimin e nxënësve me përmbajtjet mësimore përdoret prezantimi ose videoja duhet pasur kujdes që i njëjti të mos jetë shumë i gjatë, si dhe të përfshijë elemente të bashkëveprimit me nxënësit. Këto mund të jenë pyetje të shkurtra që do të parashtrohen për kohëzgjatjen e video shënimit ose anketave të shkurtra, ose diskutim në forum të caktuar, që më pas duhet të analizohet bashkë me nxënësit.

Pjesa përfundimtare e orës përdoret në mënyrë që të bëhet kthesë e gjithë asaj që është punuar në orë, me ç'rast duhet të nxiten nxënësit që t'i ndajnë në mënyrë të mëvetësishme elementet më të rëndësishme pas çdo përmbajtjeje mësimore. Gjithashtu, nxënësit duhet të mund të bëjnë reflektim të nxënies së tyre. Kjo mund të realizohet përmes diskutimit, por edhe përmes anketave, forumeve dhe ngjashëm. Në fund të orës nxënësit mund të

marrin edhe test të shkurtër me të cilin do të bëhet kontrolli i diturive të përvetësuara, e njëherësh secili nxënës do të marrë informacion kthyes për të njëjtin.

III. Pas përfundimit të orës (aktivitete asinkrone)

Aktivitete **pas orës** duhet të shërbejnë në mënyrë që të vazhdohet me aktivitete në drejtim të arritjes së qëllimeve mësimore, por në format asinkron, gjegjësisht të fitohet reflektim për qëllimet dhe përmbajtjet edukative. Këto aktivitete mund të ndërlidhen me hulumtime më të ndryshme në temën e dhënë, zgjidhje të problemit jorutinor, zbatim praktik të diturisë së përvetësuar, si dhe dhënie të detyrave të shtëpisë për nxënësit (individuale ose në grup). Me këtë rast, mësimdhënësi është i detyruar të sigurojë udhëzime konkrete për realizimin e aktiviteteve pas orës, në mënyrë që nxënësve t'u jetë e qartë ajo që kërkohet prej tyre.

Këtu mund të jepet edhe detyrë shtëpie që do ta kishin realizuar nxënësit në mënyrë të mëvetësishme ose në çifte/grupe. Ngarkesa kohore për aktivitetet e këtilla duhet të përputhet me kohën e rekomanduar për detyra të shtëpisë nga Udhëzuesi për detyra shtëpie (BZHA, 2013), me atë që nxënësit mund të përzgjedhin se kur kjo kohë ka qenë e shfrytëzuar. Njëherësh, duke marrë parasysh ekspozimin e teknologjisë gjatë pjesës sinkrone të mësimit, detyrat e shtëpisë nuk duhet domosdoshmërish të punohen me ndërmjetësim të teknologjisë.

Është me rëndësi që **pas realizimit të orës mësimore** mësimdhënësi:

- të kontrollojë mos kanë mbetur pyetje të papërgjigjura që i kanë parashtruar nxënësit në çet;
- t'u dërgojë nxënësve materiale për nxënie;
- t'i përkujtojë nxënësit për obligimet për orën e radhës;
- t'i evidentojë aktivitetet dhe arritjet individuale të nxënësve.

IV. Dhënia e detyrave të shtëpisë

Gjatë dhënies së detyrave të shtëpisë duhet pasur kujdes në moshën e nxënësve dhe kohën që nevojitet për të bërë detyrën e shtëpisë. Me fjalë të tjera, angazhimi për zgjidhjen e tyre nuk duhet t'u marrë më shumë se gjysmë ore nxënësve më të vegjël dhe më shumë se një orë për klasat më të larta, përveçse në rastet kur bëhet fjalë për projekte hulumtuese ose disa punime praktike për të cilat është e domosdoshme një kohë më e gjatë për përpilim. Dhënia e detyrave të shtëpisë nuk duhet të jetë e detyrueshme për secilën orë. Detyrat e shtëpisë, si dhe vetë ora, duhet të kenë një qëllim të caktuar, gjegjësisht duhet t'i udhëheqin nxënësit drejt rezultatit nga nxënia e asaj përmbajtjeje.

Me këtë rast duhet të insistohet që përpilimi i detyrës së shtëpisë të shpie drejt thellimit të nxënies së nxënësit, të kërkojë të menduarit e tij dhe qëndrim të mbështetur me dëshmi, përmes të cilave do të sigurohet aktivitet dhe angazhim më i madh nga nxënësit. Në këtë drejtim, nxënësit mund të përpunojnë disa projekte më afatgjata, varësisht nga dituritë dhe shkathtësitë, dhe gjithsesi njohuritë e tyre paraprake. Në mënyrë që të nxisë të menduarit kreativ dhe kritik dhe nxitje të proceseve më të larta mendore, detyrat e shtëpisë duhet të jenë në formë të eseve tematike, hulumtime për një problem të caktuar, hipoteza, projekte dhe ngjashëm. I gjithë aktiviteti i nxënësve duhet të orientohet drejt vetëshpalosjes së termeve, proceseve dhe dukurive.

Në këtë mënyrë nxënësit do të zhvillojnë kompetenca të ndërlikuara, ndërsa mësimdhënësi do të mund ta ndjekë punën e tyre dhe t'i udhëzojë në të njëjtën. Nxënësit duhet të nxiten që t'i thellojnë dituritë e tyre për kontrollimin e vlefshmërisë së informacioneve që i gjejnë onlajn, por gjithashtu edhe të kenë kujdes në licencimin e materialeve të caktuara që i gjejnë onlajn dhe që më pas duan t'i shfrytëzojnë gjatë

përpunimit të produkteve personale (para së gjithash mundësisë për përdorimin e fotografive që i gjejnë onlajn).[5]

Nëse nxënësit duhet të punojnë në grup, mund të përdoren mundësitë e ndryshme që i ofron Microsoft Office 365 për bashkëpunim, ndarje të materialeve, punë të përbashkët në projekte, etj, për shembull: punë e përbashkët e dokumenteve të ndara (Word, Excel, Power Point, OneNote). Me këtë rast secili nxënës duhet të ketë detyrë dhe përgjegjësi të dhëna saktësisht me çka mund të ndiqet më lehtë puna e tij dhe t'i jepet informacion kthyes me kohë.

Vegël e dobishme për bashkëpunim të ndërsjellë të nxënësve dhe vendosjen e detyrave në një vend ku mund të jepen informacione kthyese nga mësimdhënësi është OneNote > ClassNotebook. Nxënësit mund t'i dërgojnë detyrat e tyre në Fletoren personale në ClassNotebook ku mund t'i shikojë vetëm mësimdhënësi, i cili mund të japë informacion kthyes (lëvdata, rekomandime, vërejtje, etj.). Vegla mund të zbatohet edhe përmes PKMD-së dhe përmes MS Teams, si platformë e posaçme, ku krijohen e-fletore nga mësimdhënësit dhe mundësojnë bashkëpunim mes mësimdhënësve dhe nxënësve me mbrojtje të madhe të privatësisë. Përveç kësaj, mund të ndiqet dhe vlerësohet përparimi i secilit nxënës të përfshirë në përvetësimin e njohurive, shkathtësive dhe vlerave të përcaktuara me qëllimet e aktivitetit jashtëshkollor.



Foto 3. Shembull për detyrë të vendosur në OneNote

B. Forma dhe metoda të nxënies dhe mësimdhënies në mësimin në distancë

Përzgjedhja e metodave, teknikave, formave të mësimit dhe nxënies, si dhe aktivitete që do të realizohen për kohëzgjatjen e mësimit onlajn, duhet të bëhet me kujdes duke marrë

[5] Për më shumë informacione: http://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2014/09/OOR-vodic-br.7-web.pdf

parasysh moshën e nxënësve, njohuritë paraprake, aftësitë dhe mundësitë e nxënësve, teknologjinë e kapshme, aftësimin e nxënësve për përdorimin e së njëjtës, si dhe kornizën kohore në të cilën do të realizohet aktiviteti. Me këtë rast, me rëndësi të veçantë është fakti se kohëzgjatja dhe mënyra e realizimit të një aktiviteti të caktuar nuk janë të njëjta kur ai realizohet me prani fizike të nxënësve ose onlajn. Prandaj duhet të bëhet përshtatje përkatëse e aktiviteteve të planifikuara në përputhje me qëllimet e vendosura dhe kohëzgjatjen e mësimit onlajn, duke pasur kujdes me këtë rast që të mirëmbahet cilësia e procesit mësimor. Për këtë qëllim, një pjesë e aktiviteteve mund të realizohen para dhe pas orës në distancë, gjë që do të mundësojë hapësirë më të madhe për bashkëveprim me nxënësit gjatë vetë orës.

Gjatë përzgjedhjes së metodave, formave dhe teknikave për punë gjatë mësimit në distancë, mësimdhënësi duhet të mbajë llogari për integrimin e të tria dimensioneve të mjedisit ideal për nxënie:

- instruksione me bashkëveprim, angazhim dhe bashkëpunim;
- bashkëveprim social për zhvillimin e kontekstit social, mjedisit socio-kulturor dhe socio kognitiv;
- teknologji që nxitë mundësi për përsosje dhe zgjerim të diturisë.

Më poshtë janë paraqitur disa metoda dhe teknika të mësimit dhe nxënies, me udhëzime për përshtatjen e tyre me mësimin në distancë.

I. Diskutim

Diskutimi duhet të jetë element i përhershëm i orëve, si në klasën e rregullt, ashtu edhe në atë virtuale, veçanërisht në situata kur mësohen tema/përmbajtje që mund të shqyrtohen prej perspektivave të ndryshme dhe për të cilat nuk ka përgjigje dhe qëndrime të sakta dhe të gabuara. Diskutimi sinkron i dedikuar për sqarimin e përmbajtjeve, koncepteve, kontrollimin e të kuptuarit dhe ngjashëm, mund të nxitet përmes teknikave të ndryshme që njëherësh mundësojnë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve dhe të nxisin diskutim në nivelin e gjithë klasës/paraleles.

Njëra prej teknikave është i ashtuquajturi *Barometër i qëndrimeve*. Mësimdhënësi në ekran vendos një deklaratë të caktuar, ndërsa nxënësit përmes votimit (në pjesën e komenteve, përmes anketës ose në tabelë elektronike) shënojnë nivelin e (mos)pajtimit me deklaratën përmes shkallës së vlerësimit (nivele 1-4) pse Po/Jo përgjigje. Më pas, disa nxënës të cilët kanë qëndrim të ndryshëm (të kundërt) i argumentojnë qëndrimet e tyre, me çka nxitet diskutimi në të cilin secili nxënës ka mundësi të barabartë për të marrë pjesë. Në fund, sërish kërkohet nga nxënësit të shprehin qëndrimin e tyre përmes veglës së njëjtë prej përpara, dhe analizohet nëse dikush ka ndryshuar qëndrimet si rezultat i informacioneve të reja që i ka marrë.

Për bashkëveprim më të madh dhe përvojë "taktike", votimi mund të bëhet me tregimin e disa shenjave/gjesteve të caktuara në kamerë në mënyrë që të shënohet pajtimi, qëndrimi neutral dhe mospajtimi me prononcimin, ose nga ana tjetër objekte në ngjyrë të ndryshme (e gjelbër për pajtueshmëri, e verdhë për qëndrim neutral dhe e kuqe për mospajtueshmëri).

Teknikë tjetër është e ashtuquajtura *"Rrjetë e merimangës"* për të cilën nxënësit, para fillimit të orës duhet të përgjigjen në mënyrë të mëvetësishme në disa pyetje të caktuara nga mësimdhënësi, e më pas, gjatë orës në distancë i ndajnë përgjigjet e tyre, me çka fillohet diskutimi në grup. Derisa nxënësit diskutojnë, mësimdhënësi dëgjon dhe e paraqet në aspektin grafik rrjedhën e diskutimit përmes vizatimit të vijave mes (emrave të) nxënësve që diskutojnë, që i ngjanë rrjetës së merimangës. Në fund të diskutimit, mësimdhënësi e paraqet "rrjetin" përmes kamerës ose ndarjes në ekran dhe nxitë reflektim

për atë që është mësuar, kush ka folur, kush ka dëgjuar, kush e ka përmirësuar qëndrimin e tij nën ndikimin e të tjerëve.

Diskutimet mund të zhvillohen edhe në aktivitetin "forum" të PKMD-së ose në dokument të shpërndarë përmes OneDrive, si një lloj i aktivitetit asinkron. Mësimdhënësi mund të parashtrojë pyetje në të cilat nxënësit përgjigjen, e më pas komentojnë mes vete përgjigjet e bashkënxënësve, duke krijuar dialog. Në mënyrë që të kufizohet diskutimi, mund të dakordohen rregulla për atë se sa herë një nxënës mund të komentojë/përgjigjet në komentet e nxënësit tjetër.

II. Debati

Debati si metodë e punës mund të jetë veçanërisht efektiv në nxënien e lëndëve mësimore nga shkencat shoqërore, ku disa pyetje ose tema të caktuara nuk kanë përgjigje të sakta ose të gabuara. Debatet efektive mund t'i rrisin shkathtësitë për mendim kritik dhe komunikim të nxënësve, të nxisin bashkëpunimin mes nxënësve, si dhe mes nxënësve dhe mësimdhënësve.

Tradicionalisht, debatet mbahen në orë sy më sy me ç'rast një nxënës (ose ekip i nxënësve) mbron/afirmon pozicion ose qëndrim, ndërsa një tjetër nxënës (ekip i nxënësve) i kundërvihen kësaj. Gjatë mësimit në distancë, përgatitja për mbrojtjen e një qëndrimi të caktuar zakonisht bëhet në mënyrë asinkrone, kështu që secili nxënës hulumton dhe analizon burime të informacioneve për tezën që duhet ta përfaqësojë, me mundësi për komunikim të kohëpaskohshëm në nivel të ekipeve dhe ndjekje të procesit nga mësimdhënësi.

Faza e realizimit të debatit mund të zbatohet në dy mënyra:

- *Udhëheqje sinkrone e debatit* përmes lidhjes së video-konferencës, ku ekipeve të nxënësve u jepet mundësi për të përfaqësuar një tezë të caktuar përmes komunikimit verbal zanor, me ç'rast është përcaktuar saktësisht koha kur do të flasë secili anëtar në secilën fazë të debatit. Debati zhvillohet në tri faza: 1) fjalime hyrëse (në të cilat folësit nga ekipet kundërshtuese të nxënësve i sqarojnë argumentet e tyre me të cilat mbrojnë/kundërshtojnë një pozicion të caktuar), 2) fjalime për replikim (në të cilat folësit i përgënjeshtrojnë argumentet e ekipit kundërshtues dhe i mbrojnë argumentet personale nga përgënjeshtrimi) dhe 3) fjalime përmbyllëse (në të cilat folësit bëjnë përmbledhje të debatit nga pozicioni i ekipit të tyre dhe sqarojnë pse argumentet e tyre janë më të fuqishme/më relevante për tezën). Nxënësit të cilët nuk marrin pjesë si debatues janë me mikrofona të shkyçur dhe mund të përfshihen në rolin e komisionit për notim dhe/ose publikut, me ç'rast do të notojnë argumentimin e secilit ekip përmes listës së kritereve të përcaktuar paraprakisht. Gjatë formës së këtillë të debatit, duhet mbajtur llogari për: rregulla të vendosura qartë për mikrofon dhe kamerë të kyçur/shkyçur, mënyrat e përdorimit të veglës për bisedë (p.sh. dhënie të mbështetjes për një argument konkret nga publiku, pyetje për sqarim plotësues të argumenteve të caktuara, etj.), paraprakisht sigurim se të gjithë debatuesit kanë shpejtësi përkatëse të internetit, rregulla të vendosura qartë për renditjen dhe kohëzgjatjen e fjalimit (më së miri është që mësimdhënësi ose dikush nga nxënësit të ndjekë kohën dhe të udhëheqë). Gjatë debatit onlajn, kohëzgjatja e gjithë procesit duhet të mbetet në kuadër të gjatësisë së orës.
- *Udhëheqja asinkrone e debatit* përmes opsionit forum nga PKMD-së, me ç'rast nxënësit në kohë të ndryshme mund të arsyetojnë argumente për një tezë të caktuar përmes shënimit të tyre, por me ndjekjen e rregullave të dakorduara paraprakisht për renditjen dhe formatin e diskutimit (për shembull: si duket secila prej fazave individuale të debatit, cili ekip dhe debatues sa herë mund të parashtrojnë argument

dhe përgjigje, sa kohë zgjatë procesi dhe kur përfundon saktësisht, si ndiqet argumentimi nga nxënësit që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt si debatues, etj.).

III. Lojëfikimi (Gamification)

Lojëfikimi paraqet shndërrimin e procesit të nxënies në lojë, përmes vendosjes së elementeve karakteristike për lojërat si element themelor në procesin e nxënies. Kjo nuk është e njëjtë me nxënien përmes lojës që paraqet përdorimin e lojërave konkrete në procesin e nxënies.

Nxënia mund të modelohet sipas parimit të lojës në mënyra të ndryshme. Për shembull:

1. Përcaktimi i qëllimit që duhet të arrihet për një kohë të caktuar dhe ndjekja e përparimit. Qëllimi mund të jetë:

- qëllim konkret për nxënie, siç është zhvillimi i mirëkuptimit për një koncept të caktuar, të treguarit e përparimit ose shkathtësisë,
- qëllimi bihejviorist, si për shembull – sjellje, angazhim ose vëmendje pozitive.

Gjatë mësimit në distancë, qëllimet e përgjithshme, konkrete dhe bihejvioriste duhet të jenë të kapshme në aspektin digjital deri te të gjithë nxënësit, ndërsa përzgjedhja e tyre dhe koha për arritje të përcaktohen në bashkëpunim me nxënësit, duke nxitur autonominë e tyre në përzgjedhjen. Përparimi i dukshëm i motivon nxënësit meqë u tregon se deri ku kanë mbërritur dhe deri ku duhet të mbërrijnë. Mësimdhënësi mund të krijojë tabelë ose listë ku nxënësit do të mund të shënojnë secilin hap drejt qëllimit derisa nuk e përmbushin. Qëllimet mund të jenë të krijuara edhe si "Detyra"/Assignments të PKMD-së. Arritja e qëllimeve shënohet në mënyrë digjitale në nivel të nxënësit dhe në nivel të klasës/paraleles (nëse mësimdhënësi vlerëson se konkurrenca mund të nxisë motivim për arritje).

2. Nxitje të konkurrencës (miqësore). Organizimi i nxënies në formë të garës mund të nxisë motivim për arritje, ndonëse ekziston edhe rrezik për t'i sjellë nxënësit në situatë të konkurrencës së padrejtë ose të shkaktojë dozë të armiqësisë. Prandaj mund të përzgjidhen disa alternativa më të sigurta. Për shembull:

- **Garë në tabelë** – Grupe prej tre deri katër nxënësve garojnë për të parë se kush mund të vendosë më së shumti përgjigje ose ide në tabelën onlajn në të cilën mund të shkruajnë më shumë nxënës në të njëjtën kohë. Paraprakisht mësimdhënësi i përcakton grupet e nxënësve dhe për secilin grup mund të përcaktojë hapësirë për shkrim ose ngjyrë të ndryshme të lapsit kimik në mënyrë që të diferencohen dhe veçohen përgjigjet e grupeve.
- **Mësimdhënësi përballë nxënësit.** Ky lloj i garës është i përsosur për qëllime bihejvioriste. Mësimdhënësi mund të vendosë rregull (p.sh. Secili duhet doemos të pushojë së foluri në afat prej tri sekondave nga thirrja juaj për vëmendje) dhe t'u ndajë nga një poen nxënësve gjithmonë që do ta ndjekin këtë rregull. Nëse nuk e bëjnë këtë atëherë ky është poen për mësimdhënësin.

3. Digjitalizimi i lojërave klasike

- „Fjalëkryqi" si lojë mund të përdoret në të gjitha lëndët mësimore me krijimin e fjalëkryqit nga termet e mësuara në orë ose tema nga lënda përkatëse. Ekzistojnë më shumë ueb faqe në të cilat mund të krijohet kuis me fjalët e dëshiruara.[6] Pas krijimit,

[6] Për shembull:https://worksheets.theteacherscorner.net/make-your-own/crossword/ ose https://crosswordlabs.com/ (në anglisht)

fjalëkryqi mund të ndahet me link në mënyrë që nxënësit të mund ta zgjidhin në mënyrë të mëvetësishme, të vendoset në ueb-faqe tjetër ose mësimdhënësi mund ta ndajë në ekranin dhe ta zgjidhë bashkërisht me nxënësit.

- „Varje" është lojë e njohur gjuhësore që përdoret për mësimin e shkronjave dhe fjalëve. Përveçse në orën e gjuhës amtare mund të përdoret në pjesën përfundimtare të orës nga lëndët tjera mësimore, me atë që do të luhet "Varja" me nocione dhe terme të mësuara nga ora. Vizatimi i varjes mund të bëhet në tabelën onlajn ose në dokument të zbrazët (Paint ose ngjashëm.) në të cilin do të vizatohen dhe shkruhen shkronjat dhe fjalët.
- „Scrabble" është lojë e njohur për fjalët angleze, që mund të përdoret në mësimin në gjuhën angleze. Në këtë version nxënësi garon kundër kompjuterit me ç'rast ndiqet dhe mbahet mend rezultati i fituar. Gjatë lojës secili nxënës mund të ketë qasje deri te fjalori me qëllim që të kërkojë dhe mësojë fjalë.[7]

4. Ndarje e nxënies në nivele

Kalimi nëpër nivele deri te një qëllim i caktuar është motivues në secilën lojë dhe mund të zbatohet edhe në nxënien. Kjo nënkupton se nxënësit do të duhet të kalojnë një nivel para se të mund të kalojnë në atë të radhës. Mund të përgatitet kuis me nivele të ndryshme, me ç'rast duhet të arrihet një rezultat i caktuar në nivelin paraprak në mënyrë që të vazhdohet në nivelin e radhës. Ose mundet në materiale për nxënie, të ndara në nivele dhe kalimi nga njëri në nivelin tjetër të jetë i kushtëzuar me kalimin e kuisit për përvetësimin e nivelit. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të përparojnë në mënyrë individuale dhe të papenguar, secili me ritmin e tij.

5. Shpërblim i asaj që është mësuar/shkathtësi të përvetësuara

Sistemet për shpërblim janë faktori kryesor motivues në nxënien e bazuar në lojë. Shpërblimi mund të përbëhet nga: certifikata virtuale për një shkathtësi të caktuar të përvetësuar, fleta ngjitëse digjitale (stikerë) për nxënësit më të vegjël, dhënie të mundësisë për të zgjedhur në çka dhe si do të punojnë. Shpërblimet nuk është e thënë të jenë të rezervuara vetëm për ata që do të fitojnë, por mund të shpërblehen edhe nxënësit që vendosin rezultate të reja më të mira personale, kanë dhënë shumë mund ose bashkëpunojnë mirë me bashkënxënësit derisa e luajnë lojën.

IV. Metoda e zgjidhjes së problemeve

Metoda e zgjidhjes së problemeve – Nxënia e mbështetur në zgjidhjen e problemeve i inkurajon nxënësit që të praktikojnë shumë nga shkathtësitë si gjatë punës në studime të rastit, derisa zgjidhin probleme në mënyrë aktive. Zgjidhja e problemeve është proces mental i cili përfshin aftësinë që të analizohet dhe të arrihet zgjidhje më e mirë për një problem të caktuar. Kjo e përshkruan procesin në të cilin ekziston qëllimi që është i penguar për shkak të ndonjë arsyeje – mungesë të resurseve, mungesë të informacioneve dhe ngjashëm – që paraqet problem. Ajo që ndërmerret në mënyrë që të arrihet qëllimi i vendosur paraqet zgjidhje të problemeve. Nxënësve mund t'u jepen probleme rutinore dhe jorutinore. Problemet rutinore mund të zgjidhen me përdorimin e metodave të mësuara paraprakisht sipas parimit "hap pas hapi". Problemet jorutinore janë probleme për "të cilat ekziston qasje ose shteg i parashikueshëm, i provuar, që janë dhënë në mënyrë eksplicite në detyrën, instruksione për detyrë ose shembull i përpunuar".

[7] Ekziston edhe version onlajn si kjo në linkun: https://funkypotato.com/scrabble-online/

Nxënia përmes zgjidhjes së problemit, sipas Barmanit, përbëhet prej katër fazave të ndryshme edhe atë: angazhim, hulumtim, diskutim dhe zbatim.

1. Në fazën e parë – angazhim, përdoren strategji që duhet t'u ndihmojnë nxënësve që t'i zbulojnë njohuritë e tyre paraprake. Gjatë realizimit të kësaj faze, është me rëndësi të veçantë që të mos dënohen idetë e nxënësve, por vetëm të pranohen të gjitha idetë e arsyeshme dhe të njëjtat të analizohen shkurtimisht. Kjo fazë është më së miri të zbatohet si aktivitet sinkron gjatë orës, me qëllim që të ndahen ide dhe të paralajmërohet dhënia e problemit.
2. Në fazën e dytë nxënësve u jepet një problem për zgjidhjen e të cilit mund të përdoren strategji dhe metoda të ndryshme, por megjithatë problemi është mjaft konkret, ndërsa mënyra e formulimit të tij jep edhe udhëzim për përzgjedhjen e strategjisë dhe metodave për zgjidhjen e tij. Problemi i formuluar bashkë me udhëzimet për zgjidhje mund të jepet si aktivitet asinkron shtëpiak me afat të caktuar për realizim.
3. Në fazën e diskutimit mësimdhënësi, përmes komunikimit sinkron, inicion dhe zhvillon diskutim me nxënësit për zbulimet e tyre dhe pyetjet që i kanë parashtruar gjatë hulumtimit, i nxitë të kërkojnë informacione plotësuese për problemin që e zgjidhin.
4. Në fazën e fundit të zbatimit nxënësve u prezantohen shembuj plotësues për konceptet dhe pohimet kryesore që janë të ndërlidhura me problemin që e zgjidhin, ose nga ana tjetër, u parashtrohet një problem i ri që mund të zgjidhet me informacionet, dituritë dhe aftësitë e përvetësuara në tri fazat paraprake. Me këtë rast, në një rast ideal një ose më shumë përvoja gjatë zbatimit do të kenë lidhje të drejtpërdrejt me jetën e përditshme të nxënësve, që do të thotë se nxënësit përveçse me dituri dhe aftësi të përhershme përvetësojnë edhe ato të aplikueshme.

Nxënia përmes metodës së zgjidhjes së problemeve zakonisht është e natyrës kolaborative. Kjo do të thotë se ekipe të nxënësve punojnë përmes internetit me përdorimin e programeve me dokumente për bashkëpunim si One Drive për udhëheqjen e punës së tyre dhe ndarje të informacioneve. Derisa bisedat e vogla në grup dhe forumet mund të bëhen hapësirë dhe vegël për diskutime lidhur me aktivitetet.

V. Nxënie përmes projektit

Nxënia përmes projekteve është metodë me të cilën nxënësit hulumtojnë çështje ose probleme të ndërlikuara nga jeta reale të ndërlidhura me përmbajtjet nga programi mësimor me ndihmën e procedurave për zgjidhjen e problemeve dhe përdorimin e burimeve të ndryshme të nxënies dhe materialeve me qëllim që të arrihet produkti final. Nxënia përmes projekteve është element i rëndësishëm në realizimin e procesit mësimor, meqë mundëson përvetësimin e diturive dhe shkathtësive të ndryshme përmes përdorimit të resurseve të ndryshme dhe mënyrave të ndryshme të grumbullimit, klasifikimit dhe prezantimit të të dhënave. Përmes projekteve mundësohet që nxënësit në mënyrë të mëvetësishme (duke punuar në ekipe dhe grupe), të arrijnë në mënyrë kreative deri te më shumë njohuri për një temë të caktuar, e me këtë rast ata janë individi qendror në procesin e nxënies.

Me qëllim, përshtatjen e nxënies përmes projektit të mësimit onlajn, gjegjësisht mësimit në klasë virtuale, rekomandohet:

1. *Të fillohet me projekte të vogla/afatshkurtra*

Mund të fillohet me projekte të vogla njëjavore, si për shembull, sfidë divergjente për të menduar në të cilën nxënësit duhet të krijojnë diçka krejtësisht të re, do të përpilojnë pyetje interesante dhe do të gjejnë përgjigjet e tyre në ato pyetje. Udhëzimet mund të jepen gjatë aktivitetit sinkron, ndërsa nxënësit të punojnë një javë në mënyrë asinkrone, pas çka do t'i prezantojnë projektet e tyre në aktivitetin (orën) sinkron të radhës.

2. *Të strukturohet procesi*

Kjo është më së miri të realizohet përmes përkufizimit të fazave/hapave në projektin. Për shembull: faza e anketimit ose intervistës (grumbullimi i të dhënave)[8], faza e hulumtimit, faza e planifikimit dhe faza e krijimit. Secila prej këtyre fazave mund të realizohet në distancë, përmes kombinimit të aktiviteteve sinkrone në të cilat mësimdhënësi jep udhëzime, mentoron dhe kontrollon se çfarë është bërë, dhe aktivitete të mëvetësishme të nxënësve në të cilat grumbullojnë të dhëna, analizojnë dhe krijojnë produkt që në fund e prezantojnë.

3. *Formim i grupeve për punë në projekt*

Puna në projekt zakonisht zhvillohet në grupe ose çifte dhe në këtë mënyrë mundëson ndërvarësi në nxënien (nxënësit kanë autonomi, por ata duhet doemos të bashkëpunojnë në detyra të ndryshme të ndërlidhura). Nxënësit mund të gjenerojnë pyetje ose të zbatojnë detyra pavarësisht, e më pas mund t'i vendosin në dokument të shpërndarë ose t'i dërgojnë në formë të shpërndarë elektronike. Më pas nxënësit takohen përmes video lidhjes (përmes PKMD-së) në mënyrë që t'i analizojnë aspektet e ndryshme të pyetjes ose detyrës).

4. *Zbatim të kontrolleve të shpeshta.*

Kontrolli mund të jetë i thjeshtë si porosi përmes postës elektronike ose më i komplikuar si video bisedë, por është me rëndësi që nxënësit të dinë se kanë mbështetje. Nxënësve mund t'u parashtrohen pyetje për qëllimet dhe përparimin e tyre ose nga ana tjetër për bashkëpunimin në kuadër të grupit. Kjo mund të bëhet përmes diskutimit sinkron ose formularit elektronik me pyetje.

5. *Kombinimi i aktiviteteve para ekranit dhe më larg se ekrani.*

Gjatë nxënies përmes projektit në klasë fizike ekziston mundësi e madhe të shikoni lëvizje dhe biseda ose nxënie praktike, me vegla dhe materiale fizike. Gjatë nxënies në distancë e madhe është mundësia që nxënësit të punojnë vetë para ekranit të kompjuterit ose tabletës. Megjithatë, nxënia në distancë nuk do të thotë të kalohen orë të tëra para ekranit. Në shumë raste, mjedisi fizik në shtëpi mundet madje edhe të lejojë më shumë lëvizje sesa klasa e zakonshme. Kjo mund të ndodhë ashtu që:

- do të caktohet kohë për realizimin e projektit para ekranit dhe më larg ekranit. Mund të kushtohet një orë në distancë për mbajtjen e takimit në të cilin shkurtimisht do të paraqiten qëllimet dhe përparimi i projektit, e më pas të "dërgohen" nxënësit për të punuar diçka fizike dhe praktike.
- nxënësit duhet të gjejnë materiale dhe të punojnë në kuadër të kufizimeve kreative të shtëpisë së tyre dhe mjedisit të drejtpërdrejt për të krijuar diçka të re.
- Nxënësit mësojnë praktikisht, derisa njëherësh e përdorin telefonin e tyre të mençur ose kompjuterin për komunikim sinkron. Ata mund të shkruajnë porosi ose të realizojnë thirrje përmes platformës së dhënë shkollore për mbajtjen e orëve, në raste të nxënësve nga klasat më të larta ose shkollarët. Nëse janë më të vegjël, mund të mbeten në video-konferencë në grup të vogël. Derisa vegla për komunikim është kyçur në prapavijë, mund të punohet në mënyrë praktike.

[8]Grumbullimi i të dhënave mund të realizohet përmes veglave të ndryshme për anketim si për shembull: Mentimeter (https://www.mentimeter.com/)ose MS Forms (https://forms.office.com/Pages/DesignPage.aspx) që mundësojnë krijimin e pyetësorëve të ndryshëm onlajn dhe në mënyrë automatike i përpunojnë përgjigjet që mundëson informacion të shpejtë kthyes (për mësimdhënësit dhe për nxënësit).

VI. Vëzhgim, hulumtim dhe eksperiment

Vëzhgimi është metodë shkencore që zbatohet sipas planit të përcaktuar paraprakisht, në mënyrë që të zbulohet, përcaktohet dhe mësohet ndonjë karakteristikë e objekteve dhe dukurive të caktuara ose lidhshmëria me objekte dhe dukuri të tjera. Me këtë rast, objektet dhe dukuritë në të shumtën e rasteve shqyrtohen në mjedisin e tyre të natyrshëm.

Me **eksperiment** nënkuptohet metoda e hulumtimit të objekteve dhe dukurive, me ç'rast hulumtuesi intervenon në gjendjen dhe zhvillimin e tyre të natyrshëm, duke krijuar kushte artificiale, duke i zbërthyer në pjesë ose duke i bashkuar me objekte dhe dukuri të tjera. Me këtë rast, secili objekt ose dukuri i nënshtrohet vëzhgimit, ashtu që mund të konsiderojmë se eksperimenti dhe vëzhgimi janë dy metoda të lidhura ngushtë.

Gjatë realizimit të metodës **hulumtim**, nga nxënësit në të shumtën e rasteve pritet të punojnë në mënyrë të mëvetësishme gjatë periudhës më të gjatë kohore përmes: formulimit të pyetjes hulumtuese, hipotezave/supozimeve, metodës së kontrollit dhe testimit të supozimeve. Prandaj, hulumtimet në të shumtën e rasteve bëhen në mënyrë asinkrone, në kushte shtëpiake, ndërsa në orët e mësimit vetëm prezantohen rezultatet prej tyre, gjegjësisht të detyrave njohëse. Gjatë realizmit të mësimit në distancë, hulumtimet janë përzgjedhje e mirë për dhënien e detyrave të shtëpisë dhe për qasjen e "klasës së përmbysur". Duhet t'u jepet afat i saktë nxënësve dhe t'u bëhet e ditur se çfarë duhet të ndjekin dhe vërejnë. Mësimdhënësi mund të propozojë edhe resurse përkatëse digjitale që nxënësit mund t'i përdorin. Nëse ka mundësi te nxënësit më të vegjël është më së mirë t'u dërgohen forma, tabela ose pyetje të gatshme, në të cilat duhet të shënojnë (kjo mund të jetë në dokument elektronik). Te nxënësit më të mëdhenj mund të dërgohen instruksione më të përgjithshme pas çka ata vetë do ta kishin planifikuar mënyrën e shënimit të vëzhgimeve dhe rezultateve të tyre. Te nxënësit më të vegjël të arsimit fillor, gjatë mësimdhënies së shkencave natyrore, mund t'u jepen aktivitete me hulumtim dhe eksperimentim në kushte shtëpiake, me materiale që i kanë në shtëpi, me ç'rast për përdorim duhet të përmenden materiale që janë të sigurta. Me këtë rast mësimdhënësi mund të japë ndonjë hulumtim që rezulton nga vetë planifikimet e mësimit ose të përshtatë ide nga ueb faqe të ndryshme.[9]

Për nxënësit në klasat më të larta ose në arsimin e mesëm mund të jepen detyra që të hulumtojnë në tema të ndryshme (në mënyrë asinkrone) dhe informacionet e gjetura t'i paraqesin në formë përkatëse digjitale (prezantim, video, paraqitje grafike) dhe t'i ndajnë me nxënësit tjerë gjatë orës.

Në veglën ClassNotebook nxënësit dhe mësimdhënësi (mund të shtohen edhe mësimdhënës të tjerë) kanë hapësirë për bashkëpunim (Colaboration space) ku mund të ndajnë linqe, prezantime, fletë pune, informacione, paraqitje grafike dhe njëherësh të ndajnë, të përmirësojnë gabime, plotësojnë, etj.

[9] Ueb faqe me resurse (në gjuhën angleze) për klasë të ndryshme (moshë): https://ansp.org/exhibits/science-from-home/educator-resources/



Foto 4. Hapësirë për bashkëpunim në Class Notebook

Në shkencat shoqërore dhe artet mund të bëjnë hulumtim për: qëndrime dhe përvoja të qytetarëve për një dukuri të caktuar (përmes onlajn anketës ose video-intervistave), karakteristika në një periudhë të caktuar kohore, drejtim artistik ose individ konkret historik ose të dalluar (përmes përdorimit të videove të ndryshme, materialeve tekstuale, si dhe turneve virtuale të arritshme në internet).

Në shkencat natyrore dhe matematikë meqë hulumtimet në të shumtën e rasteve kërkojnë edhe vëzhgim dhe zbatim të eksperimenteve laboratorike ose demonstrimeve ato gjatë nxënies në distancë mund të zëvendësohen me ueb simulime dhe demonstrime përkatëse të eksperimenteve.[10]

VII. „Akullthyes“ dhe aktivitete për bërjen e pauzave mentale

Kur te nxënësit shënohen shenja të: mërzisë, shqetësimit ose humbje të vëmendjes, me siguri ka ardhur deri te stërngarkimi i aftësisë së tyre për mbajtjen e vëmendjes. Në rast të tillë, mund të bëhet pauzë e shkurtër ose lojë për defokusim me ndonjë aktivitet të pazakonshëm që do të rrënojë rutinën e pranimit të informacioneve në mënyrë të njëjtë dhe të parashikueshme. Aktivitetet e këtilla defokusuese mund të zgjasin nga disa minuta dhe të rezultojnë me kthimin e vëmendjes, por edhe mbushje me energji për ndjekjen e mëtejshme të mësimit.

Te nxënësit më të vegjël është më së miri që të bëhet ndonjë aktivitet fizik që do të përfshijë lëvizje motorike, derisa te nxënësit më të moshuar – lojë me fjalë ose gjestikulacione. Shembuj për aktivitete të këtilla që mund të zbatohen gjatë orës në klasë virtuale ka në shembullin 1.

VIII. Video mësim

Video mësimet gjegjësisht ligjëratat e regjistruara paraprakisht në video format u mundësojnë nxënësve të mësojnë në mënyrë të mëvetësishme me ritmin e tyre, në çdo kohë dhe pa prani të mësimdhënësit. Gjithashtu, mund t'u shërbejnë si material për përsëritjen dhe përcaktimin e epilogëve të miratuar. Nga ana tjetër, mësimdhënësi mund t'i përdorë këto video edhe gjatë orës në klasën virtuale në mënyrë që të evitojë përsëritjen e ligjëratave të materialit të njëjtë në më shumë klasë (grupe) të nxënësve.

Video mësimet mund të përpilohen nga mësimdhënësi, ose të huazohen dhe adaptohen nga interneti (në rast të tillë duhet pasur kujdes në licencat për përdorimin e tyre). Gjatë përdorimit të video shënimit në orë duhet doemos të merren parasysh disa segmente:

[10] Ueb faqe (në gjuhën angleze) me simulime për koncepte të ndryshme nga shkencat natyrore dhe matematika https://phet.colorado.edu/en/

Gjatësia: Video mësimet nuk duhet të jenë të gjata. Gjatësia e rekomanduar për video mësim është prej 5 deri 15 minuta. Nëse materia kërkon përmbajtje më të gjatë, është më mirë të regjistrohet një varg i video mësimeve të shkurtra.

Përmbajtje: Video mësimet duhet të jenë me strukturë të qartë që lehtë mund të shënohet me fjalë kyçe. Ato nuk duhet të përmbajnë përkufizime (mund të jenë të dhëna si koment ose material shoqërues i video mësimit, por video mësimi duhet të sqarojë qartë se ku mund të gjenden përkufizimet). Video mësimi duhet të jetë i fokusuar në sqarimin e zbatimit të ndonjë përkufizimi, ose të ndonjë shembulli konkret. Duhet të veçohen segmentet më të rëndësishme që do të shërbenin vetëm si nxitje për të menduar nga nxënësit. Gjithmonë duhet pasur kujdes në pronësinë intelektuale të përmbajtjeve që merren nga dikush, si dhe në licencën e materialeve të jashtme që mësimdhënësi dëshiron t'i përfshijë në video mësimin (fotografi, video shënime dhe ngjashëm).

Strukturë: Secili video mësim duhet të ketë strukturë kronologjike që përmban

- qëllimin e mësimit (10 % të gjatësisë)
- shembull ilustrues: pse është qëllimi i rëndësishëm, ku mund të zbatohet i njëjti (25 % e gjatësisë)
- çfarë duhet të dihet paraprakisht në mënyrë që të përcaktohen dituritë e tyre dhe ku mund të gjendet kjo dituri (5% e gjatësisë)
- elemente që duhet të përvetësohen (50 % e gjatësisë)
- cilët janë hapat e radhës (10 % e gjatësisë)

Animime: Rekomandohet që video mësimet të jenë të shoqëruara me animime, por duhet pasur kujdes që ato të shërbejnë për të orientuar fokusin drejt ndonjë qëllimi konkret edukativ, e jo të defokusohet vëmendja e nxënësit.

Mësimdhënës. Ekzistojnë dy mundësi.

- *Video mësimin e regjistron mësimdhënësi para tabelës klasike*
  Nëse mësimdhënësi prezanton para tabelës klasike duhet ta kushtojë vëmendjen në cilësinë e tingullit dhe ndriçimit. Duhet të flasë qartë, zëshëm, të shikojë drejt në kamerë dhe të theksojë segmentet më të rëndësishme në video mësimin. Në këtë variant, mësimdhënësi duhet të ketë kujdes që të mos lëvizë shumë shpejtë ose të bëjë shumë gjeste. Duhet të ketë kujdes se çfarë tregon me duart e tij, për shkak se shikuesi aty do ta orientojë vëmendjen e tij.
- *Video mësimin e regjistron me monitorin e mësimdhënësit dhe zërin (ose fytyrën) e tij*
  Nëse regjistrohet përmes monitorit të mësimdhënësit duhet pasur kujdes në përmbajtjen e segmenteve në video mësimin, të mos përmbajnë tekst të tepërt, të mos kenë shumë ngjyra që do ta ngarkonin pamjen, por të jenë mjaftë tërheqëse për ta mbajtur vëmendjen e nxënësve. Në këtë variant është me rëndësi që përmbajtja që regjistrohet të mos ndryshojë shumë shpejtë për të pasur kohë nxënësit t'i shqyrtojnë segmentet e mësimit. Mësimdhënësi duhet të ketë kujdes që të mos ketë pamje që lë përshtypje të madhe që do të zhvendoste vëmendjen e nxënësit dhe toni i zërit të ndryshojë kur mësimdhënësi dëshiron të theksojë diçka.

Udhëzime teknike:

- Video-mësimi duhet të zhvillohet sipas skenarit të përgatitur paraprakisht: që do të shkojë si përmbajtje (tekst, foto, diagrame, etj.) në çdo slajd dhe që do të flitni në secilin prej slajdeve.
- Para regjistrimit, mësimdhënësi duhet të kujdeset që të gjendet në ndonjë vend pa tinguj dhe prapavija që zhvendosin vëmendjen.

- Nëse regjistrohet ekrani i mësimdhënësit, duhet të kontrollohet nëse janë mbyllur të gjitha "gjuhët" dhe aplikacionet që mund të dërgojnë lajmërime.
- Nëse gjatë prezantimit parashtrohen pyetje/detyra të orientuara drejt nxënësve, duhet t'u paralajmërohet që ta bëjnë videon në pauzë në mënyrë që t'u përgjigjen me gojë ose me shkrim.

Krahas përgatitjes së video mësimeve personale, mësimdhënësit mund t'i përdorin edhe ato që janë vendosur në ueb portalin e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit – Eduino (www.eduino.gov.mk), dhe janë në përputhje me programet mësimore të përpiluara nga mësimdhënësit.

C. Vëzhgim, vlerësim dhe notim i mësimit në distancë

Pjesë përbërëse e procesit mësimor është vëzhgimi, vlerësimi dhe notimi. Notimi i përfshin rezultatet që janë fituar me vëzhgimin dhe vlerësimin e përhershëm të punës së nxënësve. Në mësimin në distancë theksi nuk duhet të vendoset në faktet e mësuara, por në mënyrën e kërkimit, gjetjes dhe mënyrën e përzgjedhjes së burimeve relevante të informacioneve, krahasimin e tyre, analizimin dhe vlerësimin e informacioneve, dhe në bazë të kësaj si merren konstatime dhe si formohen qëndrime. Në këtë mënyrë vlerësohen dhe notohen proceset më të ndërlikuara kognitive, ndërsa kjo i nxitë nxënësit për angazhim më të madh dhe të arritura më të larta.

Nxënësit në fillim të secilës tërësi tematike/njësie modulare njoftohen me kriteret për vlerësim dhe notim, me çka ata mund të vlerësohen vetë. Ata duhet të kenë udhëzime të qarta lidhur me mënyrat e vlerësimit dhe notimit, për atë se si të mësojnë në mënyrë të mëvetësishme, si të kontrollojnë sa kanë mësuar, cilat dëshmi duhet t'i grumbullojnë, si do të kontrollohet ajo që është mësuar, si do të formohet nota.

Mësimi në distancë shkakton ndryshime në mënyrën e vëzhgimit, vlerësimit dhe notimit të nxënësve dhe fokus më i madh vendoset në *notimin formativ*. Në notimin formativ në distancë informacioni kthyes shpesh nuk jepet në mënyrë sinkrone (të njëhershme), por prandaj ai mund të jetë më i hollësishëm dhe më konkret.

Gjatë përzgjedhjes së veglave dhe instrumenteve për notim formativ përzgjidhen ato që mund të përdoren, për shembull: projekte të nxënësve dhe hulumtime, eseje dhe prezantime, ditarë reflektues, bllogje dhe diskutime në grupe të mbyllura, e-portofol, teste me pyetje të shkurtra të eseve (me përdorimin e lejuar të burimeve të informacioneve, por kohë të kufizuar për t'u përgjigjur). Gjithmonë kur është e mundshme, mësimdhënësit duhet të hapin fushë për debate të argumentuara, në formë të shkruar, të nxisin të menduarit kritik dhe t'i ndërlidhin zhvillimet aktuale me temat që i trajtojnë.

Në OneNote ClassNotebook mund të krijohen portofola të nxënësve ku janë vendosur të gjitha punimet e secilit nxënës ndaras, informacionet kthyese, notimi formativ dhe sumativ, aktivitetet e realizuara me evidencë të saktë kohore, etj. Mësimdhënësi dhe secili nxënës kanë qasje deri te portofoli i tyre.



Foto 5. Shembull për portofol të nxënësve

Notim rrjedhës (formativ)

Metoda më e përshtatur për realizimin e kontrollit rrjedhës është kontrolli me gojë. Gjatë parashtrimit të pyetjeve me gojë duhet të njihen aftësitë e nxënësve me qëllim që mësimdhënësi t'u parashtrojë pyetje të llojit përkatës dhe me nivel përkatës të peshës. Qëllimi është që ky kontroll të jetë me qasje afirmative gjegjësisht t'u jepet konfirmim diturive të përvetësuara. Me këtë rast duhet pasur kujdes te disa nxënës të mos prodhojë pasqyrë të rrejshme për nivelin e diturive të tyre. Në mënyrë që të evitohet kjo, krahas kontrollit me gojë duhet kohë pas kohë të zbatohet edhe kontroll i shkurtër me shkrim. Këto kontrolle me shkrim duhet të marrin një pjesë të vogël të orës (10 minuta). Të zhvendosura në klasë virtuale kontrollet me shkrim mund të bëhen në ndonjërën nga format si vijon:

- Mësimdhënësi parashtron pyetje (detyra) përmes ndarjes në ekran (të shkruara në dokument ose slajd) dhe jep një kohë të caktuar për zgjidhje. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve me shkrim në fletoren e tyre ose në e-dokumentin. Më pas ia dërgojnë përgjigjet e tyre (si foto ose dokument) mësimdhënësit. Mësimdhënësi mund ta kontrollojë saktësinë e përgjigjeve dhe në mënyrë plotësuese t'u japë informacion kthyes nxënësve. Në rast tjetër mund të veçohet një pjesë e orës për leximin e përgjigjeve, ndërsa nxënësit vetënotohen sipas kritereve të dhëna.
- Krijim i dokumentit me pyetje që u ndahet nxënësve në dosje të përbashkëta/materiale të platformës për nxënie ose mundet në OneDrive. Më pas, secili nxënës krijon kopjen e tij nga dokumenti në dosjen e tij ose dosje të klasës dhe i përshkruan përgjigjet në vetë dokumentin. Edhe këtu kontrolli mund të jetë në anën e mësimdhënësit ose me vetënorim me dhënien paraprake të përgjigjeve të sakta dhe kritereve për sukses.
- Onlajn kuis – test i shkurtër onlajn me disa pyetje i krijuar nga mësimdhënësi. Nëse shfrytëzohet vegla e platformës për nxënie (ose përdoren Kahoot, Quizlet) kursehet kohë për kontrollin dhe dhënien e informacionit kthyes me atë që automatikisht pas parashtrimit të testit nxënësi merr informacione kthyes për suksesin e tij dhe i tregohen gabimet dhe përgjigjet e sakta.
- Aplikacioni MS Forms mundëson krijimin e llojeve të ndryshme të pyetësorëve onlajn dhe testeve që njëherësh i përpunon automatikisht, gjë që mundëson informacion të shpejtë kthyes (për mësimdhënësit dhe për nxënësit).



Foto 6. Shembuj të përpunimit të testit tematik

Grumbullim dhe dhënie e informacioneve kthyese

Në klasë të rregullt, fizike kur mësimdhënësi qëndron sy më sy me nxënësit, sipas komunikimit të tyre joverbal dhe gjuhës së trupit mund të vërehet lehtë nëse ligjërata është e suksesshme dhe shpie drejt arritjes së qëllimeve. Por, në klasë virtuale, gjatë aktiviteteve sinkrone kur kamerat nuk janë të lidhura, informacionet e këtilla janë të paarritshme. Prandaj duhet të grumbullohen rregullisht informacione kthyese nga nxënësit për aspekte të ndryshme të orës në klasën virtuale në mënyrë që të identifikohet "çfarë funksionon e çfarë jo". Këtu nuk bëhet fjalë për informacion kthyes për notim formativ, që fokusohet në atë se sa nxënësit e kuptojnë mirë materialin, por për informacione kthyese që do t'i ndihmojnë mësimdhënësit të vlerësojë se cilat aktivitete dhe metoda janë më të pranueshme dhe më të kuptueshme për nxënësit. Gjithashtu, do të mund të vlerësohet se sa nxënësit mund t'u qasen materialeve për aktivitete të planifikuara asinkrone ose dërgimin e detyrave të shtëpisë dhe projekteve të tyre. Mund të përdoren anketa për nxënës të krijuar përmes opsionit për anketim në PKMD ose vegla të thjeshta si Microsoft Forms në mënyrë që të parashtrohen pyetje siç janë: A keni ndonjë lloj problemesh teknike gjatë orës? Cilat aktivitete ju ishin më të vështira gjegjësisht e kishit vështirë t'i kuptoni ose zbatoni? A jeni në gjendje ta gjeni dhe ta dërgoni shpejtë detyrën tuaj të shtëpisë?

Notimi sumativ

Notimi sumativ në të shumtën e rasteve bëhet përmes vëzhgimit dhe vlerësimit të aktiviteteve si vijon: prezantim përfundimtar i punimeve në klasën virtuale, test tematik ose vjetor, pyetje të eseve për situatë hipotetike, portofol elektronik, ditarë reflektues. Për secilin instrument të përdorur, mësimdhënësi duhet të përpilojë kritere sipas të cilave do të vlerësojë rregulla të përkufizuara paraprakisht për përdorim.

Përshkrim i aktiviteteve që përdoren për notim

Prezantimi përfundimtar i punimeve në e-klasën bëhet gjatë fundit të një cikli të punës, gjysmëvjetorit ose fundit të vitit shkollor. Secili nxënës e përzgjedhë punimin e tij më të mirë. Duhet të ndahet kohë për reflektim dhe shprehjen e mirënjohjes për atë që është arritur.

Test tematik ose vjetor (kuis) për një temë të caktuar krijohet me ndërlidhjen e përmbajtjeve të mësuara, kriteret e të cilave për marrjen e pikëve do t'u jenë të njohura nxënësve.

Përparësi në kuiset onlajn në raport me ato nga letra është se mund të notohen automatikisht dhe me këtë kursejnë kohë.

Për krijimin e testeve për kontrollin e diturisë mund të përdoren funksionalitete për këtë dedikim të PKMD-së ose nga ana tjetër vegla si Kahoot, Quizlet, Socrative, që mund të jepen si link i jashtëm. Mund të përdoren edhe mundësitë e platformës për nxënie për krijimin e testeve onlajn me pyetje të llojit të ndryshëm (të mbyllura dhe të hapura) dhe mundësitë për: notim të drejtpërdrejt, ruajtje të suksesit të arritur te secili nxënës dhe zgjidhje e sërishme e testit me qëllim që të vërehen dhe tejkalohen gabimet.

Testi përbëhet prej detyrave me përgjigje të shkurtër dhe pyetje të shkurtra të eseve që rekomandohet të mbështeten në ndonjë situatë, dukuri ose problem të përshkruar hipotetik nuk kërkojnë identifikimin e përgjigjeve "të gatshme". Në këtë mënyrë barazohet në minimum mundësia për përshkrim nga ndonjë libër shkollor, interneti ose përgjigje në vend të nxënësit. Duhet t'u lejohet nxënësve të përdorin burime të informacioneve, por me kohë të kufizuar të përgjigjes. Koha për zgjidhjen e llojit të këtillë të testit, do të zgjasë një orë, gjegjësisht maksimum 30-35 minuta. I kushtohet kujdes numrit të detyrave që mund të zgjidhen në këtë kohë. Përdoret ndonjëra nga veglat elektronike për përpilimin e test detyrave që paraprakisht është përdorur me nxënësit për vetëkontrollim të diturive. Ky instrument përdoret edhe për notimin formativ.

Në mënyrë që të nxiten nxënësit për punë të vazhdueshme, mund të kërkohet, në testet për vetëkontrollim të thjeshtë (kuiset e përpiluara në ndonjërën prej veglave digjitale) nxënësit të marrin një numër të caktuar të pikëve para se të zgjidhin testin tematik/vjetor.

Të gjithë nxënësit duhet ta punojnë testin në të njëjtën kohë që është përcaktuar paraprakisht. Nëse për arsye teknike disa nxënës janë të penguar të punojnë testin, duhet të përgatitet një test tjetër për ata nxënës që do të përgjigjen në kohë tjetër. Nxënësit duhet të kontrollohen përmes Platformës kombëtare derisa t'i përgjigjen testit. Nëse nuk ka mundësi teknike, realizimi i testit të këtillë është i mundshëm edhe pa ndjekje vizuale sinkrone të nxënësit.

Eseja është mënyrë e mirë edhe për notimin formativ edhe për atë sumativ, për shkak se kërkon ndërlidhje të përmbajtjeve prej më shumë fushave, ndërlidhje të tyre me situata reale jetësore dhe kontrollohet përdorimi i proceseve më të ndërlikuara mendore. Eseja që përdoret për notim sumativ duhet të jetë mirë i menduar dhe të gjithë nxënësit ta punojnë në të njëjtën kohë që është dakorduar paraprakisht. Koha për shkrimin e esesë rekomandohet të jetë 60 minuta. Në kushte të mësimit në distancë, më së mirë është që kjo të realizohet në "bllok" orë, nëse ka mundësi të tillë. Mëvetësia në punë kontrollohet përmes Platformës kombëtare. Paraprakisht duhet të dihet në çfarë kohe do të shkruhet eseja dhe nxënësit duhet t'i kenë marrë paraprakisht kriteret për notim. Nëse mësimdhënësi konsideron se nevojitet të vëzhgojë mëvetësinë gjatë punës, mund t'u tregojë nxënësve që të punojnë me kamera dhe mikrofona të kyçur.

Portofoli elektronik është vegël e domosdoshme në notimin në distancë për shkak se i mundëson nxënësit që të vëzhgojë përparimin personal, të përmirësohet dhe të dokumentojë përparimin. Kjo i mundëson të ruajë lloje të ndryshme të punimeve, në mesin e të cilave edhe ato multimediatike. Mësimdhënësit, nga ana tjetër, i mundëson të vëzhgojë nxënësin, ta notojë në mënyrë formative dhe sumative, si dhe të dokumentojë notimin. Nxënësit në portofolat e tyre elektronike duhet t'i ruajnë të gjitha punimet.

Mësimdhënësit mund të shënojnë te ata informacione kthyese gjatë notimit formativ, por për nevojat e notimit sumativ duhet të kërkohet nga nxënësit që të bëjnë portofol reprezentativ në bazë të udhëzimeve që do t'u jepen për përmbajtjen e tij.

Për e-portofolin nevojitet që paraprakisht të planifikohet:

- përkufizimi i formës dhe vëllimit të udhëzimit: që duhet të përmbajë portofolin dhe që duhet të përfshihet si bazë për përmbledhjen e notës;
- natyra dhe vëllimi i punës individuale;
- si duhet procesi dhe progresi të përfshihen në bazën për vlerësimin e portofolit si tërësi;
- renditje kronologjike e parashtrimit të punës individuale;
- përzgjedhje e renditjes së punimeve;
- afate për dërgimin e secilës detyrë;
- si duhet të dërgohet/bëhet puna, duke përfshirë edhe detyrat zgjedhore dhe të detyrueshme;
- cilat detyra duhet të dërgohen si detyrë në grup;
- kriteret për vlerësim të punës që është përfshirë në vlerësimin e portofolit në tërësi.

Platforma kombëtare për nxënie në distancë ka opsion të integruar "Ditar për nota", që në njëfarë mënyre paraqet portofol elektronik që në vete i përmban të arriturat e nxënësit për secilin aktivitet që duhet të realizohet në kuadër të lëndës. Ditari për nota në fakt paraqet pasqyrë të arritjeve në nivel të paraleles në aspektin e aktiviteteve që u janë dhënë nxënësve. Për secilin aktivitet identifikohet arritja e nxënësit për të njëjtin, me mundësi që drejtpërdrejt t'i qaset vetë aktivitetit dhe punimit të nxënësit. Për shembull, nëse në paralelen realizohet test, i njëjti do të paraqitet në ditarin për vlerësim dhe për secilin nxënës do të paraqiten numri i pikëve të fituara në testin, ndërsa mund të hyhet drejtpërdrejtë edhe në përgjigjet e nxënësit në vetë testin. Kjo është mënyrë e shpejtë, e thjeshtë dhe gjithëpërfshirëse për ndjekjen e përparimit të nxënësve. I njëjti mund të përdoret edhe për analizë të cilësisë së pyetjeve në vetë testin për mësimdhënësin (nëse shumica e nxënësve kanë më pak pikë ose nuk kanë pikë në një pyetje të caktuar, mund të rishqyrtohet nëse pyetja ka qenë e parashtruar mirë ose nga ana tjetër nëse nxënësve u nevojiten informacione plotësuese në raport me këtë pyetje/detyrë).

Përveç kësaj, vegla e përshkruar më sipër ClassNotebook, mund të përdoret me mjaft sukses për krijimin e portofolit elektronik për secilin nxënës dhe dhënie të informacionit kthyes formativ deri te i cili kanë qasje mësimdhënësi dhe secili nxënës individualisht.

Ditarë reflektues udhëhiqen në mënyrë elektronike për shkak se nxënësi shpenzon më pak kohë për shkrim dhe mund t'i plotësojë më lehtë dhe në këtë mënyrë të bëjë reflektim më të thellë për nxënien që kontribuon në udhëheqjen e nxënies personale. Ditarët reflektues dorëzohen në fund të secilës temë të përpunuar. Ato janë burim i vlefshëm për të kuptuarit e nxënësve dhe vështirësive me të cilat përballen në bazë të së cilës duhet të modifikohet mësimdhënia.

D. Orë të përbashkëta në distancë

Në sistemin tonë arsimor, termi "orë të përbashkëta" është tashmë i dallueshëm. Ato janë orë mësimore që realizohen me nxënës të dy paraleleve me mësim në dy gjuhë të ndryshme mësimore, të kryesuara nga dy mësimdhënës që orët i realizojnë në dy gjuhë, duke i respektuar kriteret për realizimin e orëve të përbashkëta. Qëllimi i orëve të

përbashkëta është nxënësit të përvetësojnë shkathtësi dhe të mësohen me bashkëveprimin që është i domosdoshëm për jetesën e përbashkët në shoqëri multietnike.

Mësimi onlajn në orë të përbashkëta ka specifika në mënyrën e planifikimit dhe përgatitjes, organizimit dhe realizimit. Suksesi i orëve të përbashkëta para së gjithash varet nga gatishmëria e mësimdhënësve, planifikimi i përbashkët për mësim dhe respektimi i rregullave për orë të përbashkëta gjatë realizimit të mësimit onlajn.

Përgatitje dhe planifikim i orëve të përbashkëta në distancë

Gjatë planifikimit dhe përgatitjes së mësimit në distancë, mësimdhënësit duhet së bashku të:

- analizojnë programin mësimor nga lënda mësimore që do ta realizojnë së bashku;
- identifikojnë tërësi tematike/njësi modulare dhe/ose përmbajtje mësimore që mund t'i realizojnë së bashku me sukses;
- përkujdesen që përfaqësimi i orëve të përbashkëta në raport me nurin e përgjithshëm vjetor të orëve për lëndën mësimore të mos jetë më i vogël se 50%;
- sigurojnë materiale dhe resurse elektronike në dy gjuhët mësimore;
- realizojnë qëllimet dhe rezultatet e përcaktuara tërësisht nga nxënia nga programi mësimor;
- përcaktojnë vegla digjitale, metoda, forma dhe mënyra të punës që sigurojnë komunikim më të thjeshtë dygjuhësor;
- përcaktojnë vegla digjitale për kontrollimin e arritjeve të nxënësve;
- vendosin kritere dhe mënyra të vlerësimit të nxënësve;
- prezantohen si model për nxënësin, në drejtim të edukimit për respektimin dhe pranimin e dallimeve, uljen e paragjykimeve dhe ngjashëm. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet:
- planit për mënyrën e ligjërimit dhe dhënies së instruksioneve në dy gjuhë të ndryshme;
- përzgjedhjes së metodës për ndarje në grupe më të vogla;
- detektimit të asaj që është e përbashkët dhe u takon nxënësve nga të dyja gjuhët mësimore (kulturë, gjuhë, histori, etj.)
- inkurajimit të nxënësve që të shprehen lirisht dhe të prononcohen në gjuhën që e ndjejnë më së miri;
- njohjes së veçorive karakteristike të të gjithë nxënësve dhe planifikimit të qasjes individuale;
- marrëveshjes se si do të sillen në orë gjatë situatave eventuale të paparashikueshme;

Organizim i orëve të përbashkëta në distancë

Ekzistojnë mënyra të ndryshme të organizimit dhe strukturimit të mësimit onlajn, veçanërisht kur bëhet fjalë për mësim në dy gjuhë mësimore. Duhet të merren parasysh shumë faktorë, për shembull të detektohet "niveli" i ndarjes së nxënësve dhe mundësitë për bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e tyre me bashkënxënësit. Për shembull: Sa nxënës e njohin gjuhën e tjetrit dhe ata të vendosen si liderë të grupeve më të vogla që do të punojë në detyra të projektit.

Gjatë organizimit të mësimit është me rëndësi:

- përmbajtja të ndahet në tërësi më të vogla dhe sipas renditjes të paraqiten nga përmbajtjet më të thjeshta drejt atyre më të ndërlikuara;
- materiali të prezantohet në "racione" të vogla në dy gjuhët, në mënyrë vijuese;
- resurset për nxënie është e domosdoshme të sigurohen në dy gjuhët;
- koha për realizimin e orës duhet të organizohet mirë.

Realizimi i orëve të përbashkëta onlajn

Gjatë realizimit të orës së përbashkët në distancë, mësimdhënësit me sjelljen dhe mënyrën e tyre të komunikimit duhet të sigurojnë atmosferë të rehatshme në mënyrë që secili nxënës të mund të ndjehet komod dhe i sigurt.

Prezantimi, dhënia e instruksioneve, dhënia e informacionit kthyes gjithmonë duhet ta ndjekë renditjen si vijon: fillon mësimdhënësi 1 në një gjuhë, jep një informacion. Vazhdon mësimdhënësi 2 në gjuhën tjetër mësimore, e jep informacionin e njëjtë dhe vazhdon me informacion tjetër, më pas vijon mësimdhënësi 1 me informacionin plotësues të dhënë paraprakisht nga mësimdhënësi 2 dhe informacion të ri, etj.

Gjatë realizimit të orës, është me rëndësi që t'u kushtohet kujdes gjërave si vijon:

- Informacionin e ri nuk duhet gjithmonë së pari ta dëgjojnë nxënësit e gjuhës së njëjtë mësimore.
- Gjatë orës, nuk përkthehet, por parafrazohet.
- Mësimdhënësit kanë vazhdimisht qasje të njëjtë ndaj të gjithë nxënësve dhe përkujdesen për bashkëveprimin më të madh të nxënësve
- Detyrat e projektit realizohen në grupe "të përziera" më të vogla të nxënësve
- Evidencën për arritjen e nxënësve e udhëheqin dy mësimdhënësit.

Procedura për formimin e grupeve të nxënësve për realizimin e orës së përbashkët, përmes PKMD-së dhe drejtpërdrejt përmes Microsoft Teams janë dhënë në Shembullin 3. Udhëzimet e njëjta teknike mund të përdoren dhe nëse realizohen orë me përmbajtje të integruara, në paralelen e njëjtë prej dy mësimdhënësve të lëndëve të ndryshme mësimore, me ç'rast bëhet fjalë për përmbajtje të ndërlidhura për nxënie.

6. Nxitje të interesit dhe mirëmbajtjes së motivimit për nxënie

Ndonëse disa forma të caktuara të bashkëveprimit dhe angazhimit të nxënësve janë të kufizuara për shkak të mësimit në distancë, njëherësh teknologjia dhe mësimi onlajn mundësojnë një lloj tjetër të angazhimit përmes mënyrave të ndryshme të bashkëveprimit, detyrave dhe aktiviteteve.

Në mënyrë që të nxitet interesi i nxënësve dhe të mirëmbahet motivimi për nxënie, mësimdhënësve u rekomandohet të përkujdesen për aspektet vijuese që janë të rëndësishme për mirëmbajtjen e interesit dhe motivimit për nxënie:

1. Marrje të informacioneve për interesin e nxënësve për lëndën, përmbajtjet, mënyrat e nxënies

- Është mirë që mësimdhënësi të bëjë anketa të kohëpaskohshme të shkurtra elektronike për kontrollimin e interesit të nxënësve për përmbajtjet mësimore dhe mënyrat e mësimit dhe nxënies, me qëllim që të përshtatet mësimi në bazë të të dhënave që i kanë marrë nga nxënësit. Të njëjtat mund të ndahen me nxënësit përmes funksioneve për

anketim të përfshira në PKMD-në ose format tjera për anketim që janë të kapshme për mësimdhënësin dhe nxënësit.
- Përdorimi i dosjes së shpërndarë (në One Drive) në të cilën nxënësit vetëm do të mund të kontribuojnë me idetë e tyre për përmbajtje dhe aktivitete që kanë të bëjnë me materialin mësimor.

2. Vendosja e qëllimeve për nxënie: në nivel të grupit dhe individualisht

- mësimdhënësi mund të bëjë një listë me qëllime/rezultate nga nxënia (në Excel dokument të shpërndarë në One Drive)
- në të cilën secili nxënës do të mund ta vlerësojë nivelin personal të arritjeve të rezultateve dhe të planifikojë nxënien e mëtejshme.
- Në fund të orës/aktivitetit sinkron, nxënësit, në dokument të shpërndarë ose me vendosjen e shenjave në tabelë elektronike, mund ta vetëvlerësojnë nivelin e pjesëmarrjes, ndjenjës së përkatësisë ndaj grupit dhe bashkëveprimit me nxënësit tjerë.

3. Vëzhgim dhe kontrollim i interesit dhe fokusimit gjatë orës

- Në fillim të orës dhe disa herë gjatë aktiviteteve sinkrone, rekomandohet parashtrimi i pyetjeve të shkurtra në të cilat duhet të përgjigjen të gjithë nxënësit. Mënyrat e përgjigjes mund të jenë të ndryshme: një fjalë/fjali ose simbol në komente ose në kamerë, në tabelë elektronike përmes opsionit annotate, në dokument të shpërndarë për plotësim nga të gjithë). Mësimdhënësi duhet të vendosë se cilin opsion do ta përdorë dhe paraprakisht t'i përgatisë pyetjet, format që do t'i përdorë.
- Mësimdhënësi përmes aktiviteteve të shkurtra mund të kontrollojë rregullisht nivelin e energjisë mes nxënësve, p.sh. përmes votimit, shpalljes, emocioneve për disponimin dhe ngjashëm dhe kur do të vlerësojë se është e nevojshme, të përfshijë energejzer virtual (Shembulli 1)

4. Nxitje të autonomisë dhe nxënies së vetëudhëzuar

- Nëse ekziston mundësia, nxënësve duhet t'u lejohet të përzgjedhin mënyrën dhe veglën me të cilën do të përpunojnë një pjesë të detyrave: tekst, PowerPoint prezantim, video, audio
- Mësimdhënësi mund të emërojë nxënës-ndihmës gjatë realizimit të orës (është mirë të mos jenë gjithmonë nxënësit e njëjtë, por të ketë sistem të rrotacionit. Përgjegjësitë e tyre mund të ndërlidhen me: ndjekjen e komenteve, përgatitjen e tabelave/paraqitje grafike në tabelë elektronike ose në dokument të shpërndarë, përkujdesje për disiplinën gjatë aktiviteteve sinkrone dhe shënimin e përparimit gjatë aktiviteteve asinkrone.
- Pas përfundimit të sesionit sinkron në të cilin është zhvilluar diskutimi produktiv, nxënësve duhet t'u mundësohet ta vazhdojnë diskutimin për një përmbajtje të caktuar që veçanërisht i ka interesuar dhe të propozojnë tema të radhës për diskutim.

7. Përkujdesje për aspektet socio-emocionale të nxënies

Gjatë nxënies në distancë, krahas distancës fizike nga nxënësit, rritet edhe distanca psikologjike dhe emocionale dhe në këtë mënyrë ulet gradualisht kohezioni grupor që është i rëndësishëm për nxënie efektive. Prandaj duhet të bëhet përpjekje plotësuese për të krijuar ndjenjën për bashkësi në klasën virtuale.

Me qëllim që të mirëmbahet ndjenja e bashkësisë dhe t'u përgjigjet nevojave socio-emocionale të nxënësve, rekomandohet të kushtohet kujdes për aspektet si vijon:

1. Grumbullim i vazhdueshëm i informacioneve për nivelin e mirëqenies së nxënësve, kontekstit të tyre jetësor dhe orarit ditor

- Nëse mësimdhënësit punon me numër më të vogël të nxënësve, ky qëllim mund të arrihet përmes kontaktit të drejtpërdrejt përmes lidhjes telefonike ose video me secilin nxënës individualisht, me qëllim që të shqyrtohet se cilat janë mundësitë dhe kushtet e punës të secilit nxënës, dhe në mënyrë përkatëse t'u jepet mbështetje nxënësve të cilët kanë nevojë. Nëse vlerëson se është e përshtatshme, mësimdhënësi mund t'i inkurajojë pjesëmarrësit që të përdorin kamerën e tyre për ta treguar "klasën e tyre shtëpiake".
- Nëse mësimdhënësi ka numër të madh të nxënësve, mund të zbatojë anketa të kohëpaskohshme (p.sh. çdo muaj) për kontrollin dhe vlerësimin e mirëqenies së secilit nxënës dhe rrethanave të tij/të saj jetësore. Më së miri është nëse anketat janë bërë në bashkëpunim me shërbimin pedagogjik-psikologjik dhe analizohen bashkërisht, ndërsa nxënësve u është dhënë mundësia për anonimitet, por njëherësh edhe kod për identifikim.
- Mund të përdoren aktivitete të shkurtra bashkëvepruese në mënyrë që nxënësit të mësojnë më shumë për vete dhe për bashkënxënësit e tyre, siç është ndarja e këngës/telenovelës së preferuar ose kanakarit familjar. Përveç kësaj, koha e pastrukturuar para fillimit të aktiviteteve sinkrone mund të përdoret për bisedë joformale deri në lidhjen e të gjithë nxënësve dhe fillimin e orës.

2. Identifikim dhe mirëkuptim i emocioneve personale

- Gjatë aktiviteteve sinkrone, ku mësimdhënësi ka numër të madh të nxënësve të cilëve u ligjëron, mund të vendoset praktikë e kontrollimit të gjendjes emocionale të secilit nxënës në fillim të ditës/orës. Gjatë sesioneve sinkrone, nxënësit mund të: përzgjedhin reagime emocionale nga lista që do t'ua paraqesë mësimdhënësi, me ç'rast mund: të shënojnë në tabelë elektronike ku është vendosur lista e emocioneve, me një fjalë ose emotikon të përshkruajnë se si ndjehen në pjesën e komenteve, t'i shënojnë emocionet e tyre në termometër "emocional" të shpërndarë përmes dokumentit të përbashkët ose të vendosur në tabelë elektronike. Shiko Shembulli 2.
- Gjatë aktiviteteve asinkrone, nxënësit mund t'i shënojnë ose përshkruajnë nevojat e tyre, gjendjet emocionale dhe mundësitë për ndjekjen e mësimit, në format për reflektim që mund t'i dërgojnë deri te mësimdhënësi me frekuencë të përcaktuar paraprakisht (p.sh. një herë në javë ose një herë në muaj). Në bazë të informacioneve që i ka marrë, mësimdhënësi mund të vlerësojë nëse nxënësve të caktuar u nevojitet mbështetje plotësuese nga shërbimi profesional dhe t'i orientojë në mënyrë përkatëse. Shiko Shembulli 2.

3. Mundësim i bashkëpunimit mes nxënësve dhe vendosje të ndjenjës së bashkësisë

- Nxënësve duhet t'u jepen mundësi dhe të nxiten për komunikim joformal, në bazë të interesave të tyre ose përvojave të përbashkëta. Për këtë mund të përdorin grupe personale të platformave të ndryshme sipas zgjedhjes së tyre dhe të përdoren mundësitë që i ofrojnë aktivitetet jashtëmësimore të cilat mbështeten në interesat personale të nxënësve.
- Mësimdhënësi, në marrëveshje me nxënësit duhet të mundësojë opsione për mbështetje dhe inkurajim të ndërsjellë mes nxënësve për një qëndrim, mendim të

shprehur, për shembull: gishtin e madh të ngritur, duartrokitje (pa zë) ose ndonjë sistem të gjesteve/lëvizjeve të dakorduara në mënyrë të ndërsjellë.

- Çdo javë ose ditë mund të fillohet me një dëshirë të shkurtër për ndërtimin dhe nxitjen e bashkësisë, besimit dhe mirëqenies. Ky mund të jetë aktivitet për orën e kujdestarisë, si pjesë e Arsimit për shkathtësi jetësore, por edhe në kuadër të orëve të tjera.
- Aktiviteti përfundimtar për reflektim në orë (ditë) mund të përfshijë: secili nxënës të ndajë një moment të orës (ditës) për të cilin është falënderues, moment për të cilin dëshiron të kërkojë ndjesë ose aha-moment, diçka që ka mësuar dhe ka qenë interesante për të.

4. Përkufizimi i rregullave të sjelljes

- Bashkërisht, përmes metodave demokratike, klasa/paralelja duhet të dakordojë disa rregulla të reja themelore të sjelljes gjatë orëve (sesione sinkrone), por edhe jashtë orëve. Për shembull: kur flitet, si lajmërohet për fjalë, si sillemi ndaj njëri-tjetrit, rregullsi, të qenët me kohë, transparencë, si paralajmërohet nëse dikush duhet të shkyçet nga ora, si të veprohet nëse dikush nuk sillet në kuadër të rregullave, kur është e lejuar që të përdoren shenja/emotikone, derisa nxënësi flet atë ta bëjë me kamerë të kyçur me çka ndiqet edhe pjesa e komunikimit joverbal dhe mëvetësisë së nxënësit, etj.).
- Lista me rregulla duhet të vendoset në dokument të shpërndarë në OneDrive në mënyrë që të jetë nën shqyrtimin e të gjithë nxënësve dhe të mund të propozohen edhe rregulla plotësuese.

5. Respektim i individit të nxënësit dhe sigurim të raportit korrekt

- Secili nxënës duhet të ketë mundësinë për t'u shprehur në mënyrën në të cilën është më adekuate për të (në mënyrë zanore, të shkruar, simbolike). Për shembull, nëse ka vështirësi të shprehet me gojë, të ofrohet mundësia për të përdorur opsionin chat ose ndonjë lloj tjetër të komunikimit me shkrim.
- Secili nxënës duhet të marrë kohë për të shprehur qëndrimin e tij, për aq sa i nevojitet. Nëse nuk ka kohë të mjaftueshme gjatë aktivitetit sinkron, mund të ofrohet mundësi që ta shprehë qëndrimin në mënyrë asinkrone, përmes tekstit ose videos, e më pas ta shpërndajë në mënyrë plotësuese.
- Secilit nxënës i jepet informacion konstruktiv kthyes, që mund të jepet me gojë gjatë aktivitetit sinkron, por që të jetë më i hollësishëm, më së mirë është që të jepet në mënyrë asinkrone, në formë të tekstit ose videos (veçanërisht për nxënësit më të vegjël).

Shembuj

Shembulli 1. Shembuj të „Akullthyesve“ dhe aktiviteteve për bërjen e pauzave mentale

Në vazhdim disa ide për aktivitete që mund të zbatohen gjatë orës në klasën virtuale:

- **„5-4-3-2-1“** – Në këtë lojë të thjeshtë, nxënësit ngrihen nga karrigia e tyre dhe e largojnë anash ose sa është e mundshme mbrapa në mënyrë që të ketë hapësirë për lëvizje pa pengesa. Nxënësit mund të përzgjedhin nëse do t'i kyçin kamerat e tyre gjatë zbatimit të këtij aktiviteti. Mësimdhënësi u thotë të bëjnë pesë lëvizje të ndryshme në renditje rënëse. Për shembull, mësimdhënësi mund të thotë: “Kërceni në vend 5 herë, rrotullohuni 4 herë, kërceni në njërën këmbë 3 herë, shëtitni nëpër dhomë 2 herë, duartrokitni një herë“. Me këtë rast, mësimdhënësi bën pauza mes secilit prej aktiviteteve në mënyrë që ta bëjnë të gjithë nxënësit dhe vazhdojnë me atë të radhës.
- **„Zari vendosë“** – Ky aktivitet është i ngjashëm me atë paraprak me atë që përpilohet një listë prej 6 aktiviteteve që prezantohen në tabelë si në vizatimin. Kjo ndahet në ekran në mënyrë që të jetë e dukshme për nxënësit.

	Vrapo në vend 10 sekonda!		Kërce në vend 10 herë!
	Gjunjëzohu 10 herë!		Bëji 5 pompa!
	Bëji 10 lëvizje rrethore me duart!		Lëvize gjithë trupin 10 sekonda!

Më pas hidhet zari në mënyrë që të përzgjidhet se cilin aktivitet ta bëjnë nxënësit. Dhe kjo përsëritet disa herë. Në klasën virtuale mësimdhënësi mund të përdorë hedhjen virtuale të zarit si vegla „Hidh zarin" në Google.

- **Sfidë fizike** – Sfidoni nxënësit të bëjnë diçka që është e vështirë e realizueshme në aspektin fizik si për shembull: qëndrim në një këmbë me duar të shtrirë lartë. Ose: kape hundën me dorën e majtë dhe kape veshin e majtë me dorën e djathtë, e më pas shpejtë ndërroi duart ashtu që dora e djathtë do ta mbajë hundën, ndërsa dora e majtë do ta kapë veshin e djathtë. Për sfidë fizike mund të përdoren edhe joga pozicione.
- **Të ngrirë!** Për këtë aktivitet duhet të kërkohet nga nxënësit që të ngrihen dhe të pastrojnë hapësirën rreth tyre, në mënyrë që të mund të lëvizin lirshëm dhe t'i kyçin kamerat. Mësimdhënësi gjen ndonjë muzikë interesante për vallëzim dhe kur do të fillojë muzika fëmijët duhet të fillojnë të vallëzojnë. Kur muzika do të ndalet fëmijët duhet të “ngrijnë” gjegjësisht ta ruajnë pozicionin në të cilin janë hasur gjatë ndërprerjes së muzikës derisa sërish nuk fillon muzika.
- **Numërim me kërcim** – Ky aktivitet do t'u japë energji nxënësve derisa numërojnë. Për shembull, tregojuni të fillojnë nga 5 dhe të numërojnë përpara nga 10 derisa kërcejnë në vend. Ose mund të numërojnë terme në pyetje që përfshin numërim (për shembull, qytete në Maqedoni) derisa kërcejnë në vend.

Nxënësit më të rritur zakonisht kanë rezistencë ndaj aktiviteteve fizike, gjegjësisht ndjehen pakëndshëm që t'i ushtrojnë. Prandaj me ta është më së mirë të bëhet një lojë e shkurtër mendore. Për shembull:

- **Asociacion** – Gjatë takimeve të sinkronizuara, mund të bëhet pauzë e shkurtër përmes gjetjes së fjalës ose termit përmes disa përshkrimeve me fjali. Me këtë rast mund të bëhet një slajd në të cilin janë shënuar fjalitë për përshkrim në vetën e parë dhe është vendosur fotografi nga kutia me titull: Çfarë fshihet në kutinë? Ose Kutia misterioze. Nxënësit mund të qëllojnë me ngritjen e dorës ose shkrimin e përgjigjes në veglën për "Bisedë".
- **„Më shumë do të doje ... ose të..."** – Për këtë lojë përpilohen më shumë pyetje interesante që nuk kanë pikëtakimi me temën e takimit sinkron. Krijohen slajde me pyetjen me dy opsione me ç'rast nxënësit duhet të përzgjedhin vetëm një përgjigje. Për shembull "Më shumë do të doje të mund të fluturosh ose të jesh i aftë për teleportim?", "Më shumë do të doje të lash enë ose të fshish pluhurin?", "Më shumë do të doje të jesh këngëtari më i mirë ose valltari më i mirë?". Më pas, në kohë përkatëse nga takimi sinkron (p.sh. pauzë, kalim mes pjesëve të ndryshme) mund të zbatohet aktiviteti. Me këtë rast tregohen edhe rregulla si si nxënësit të përgjigjen në pyetjet. Mundet: trego një gisht për opsionin 1, dy gishta për opsionin 2, nëse u janë kyçur kamerat. Ose të shkruajnë 1 ose 2 në veglën për Bisedë.
- **Gjeje shpejtë** - Ky aktivitet është i dedikuar në mënyrë që nxënësit të defokusohen nga ekrani dhe të vihen në lëvizje. Gjatë takimit sinkron, mësimdhënësi tregon një ngjyrë ose ndonjë veçori tjetër (p.sh. diçka të rrumbullakët, diçka prej druri) dhe nxënësit duhet të gjejnë ndonjë send në dhomën e tyre ose shtëpinë që e ka atë veçori dhe ta sjellin sa më shpejtë dhe ta tregojnë para kamerës. Kjo mund të bëhet edhe si garë, me ç'rast nxënësi që do të tregojë i pari sendin është fitues i raundit dhe luhen disa raunde.

Shembulli 2. Shembuj për aktivitete për nxënie socio-emocionale

Shembuj të aktivitetit: „Ulje"

Udhëzime: Gjithë klasa/paralelja mund të bëjë aktivitet sinkron, në fillim të ditës ose të javës. Mësimdhënësi i udhëheqë, duke i lexuar udhëzimet. Nxënësit mund: të ndajnë publikisht një pjesë të përgjigjeve, të shënojnë secili për vete ose të ndajnë në çifte. Ndarja me gjithë grupin (klasë, paralele) rekomandohet në situata kur ekziston besim i ndërsjellë dhe ndjenjë e bashkësisë.

1. Merr 5 frymëmarrje të thella

2. Shëno 4 gjëra që mund t'i shohësh rreth vetes

3. Numëroi 3 gjëra për të cilat je falënderues/falënderuese (i lumtur/e lumtur)

4. Trego 2 gjëra pozitive për veten

5. Përmende 1 gjë për të cilën gëzohesh gjatë ditës së sotme/javës

*Përshtatur nga: https://www.thepathway2success.com/sel-lessons-and-activities-for-the-virtual-classroom/

Shembull i aktivitetit: Zonë e rregullimit

Udhëzime: Mësimdhënësi i paraqet fotografitë dhe tekstin dhe jep udhëzim: Shikoni fotografitë dhe në komente (ose në tabelën onlajn) shënoni se si ndjeheni ose në cilën zonë gjendeni në këtë moment.

ZONA E KALTËR	ZONA E GJELBËR	ZONA E VERDHË	ZONA E KUQE
Pikëlluar	Lumtur	Nevrikosur	Hidhëruar
Dhimbshëm	Qetë	Brengosur	Zemëruar
Lodhur	OK	Emocionuar	Trishtuar
Mërzitur	Koncentruar	Krisur	Bërtitje/goditje
Lëvizje e ngadalshme	Gati për udhëheqje	Kontroll i humbur	Pa kontroll

Shënim: Aktiviteti mund të bëhet edhe në mënyrë asinkrone, nga secili nxënës individualisht në fletë pune, me ç'rast fletën e plotësuar e dërgon drejtpërdrejt te mësimdhënësi dhe merr informacion kthyes individual (dhe përfshin një anëtar të shërbimit profesional nëse vlerëson se ka nevojë).

*Përshtatur nga:
https://www.zonesofregulation.com/uploads/3/4/1/7/34178767/english_reproducible_e.pdf

Shembull i aktivitetit: Termometër për brengosje

Shënim: Aktiviteti mund të bëhet edhe në mënyrë asinkrone, nga secilit nxënës individualisht në fletë pune, me ç'rast fletën e plotësuar e dërgon drejtpërdrejt te mësimdhënësi dhe merr informacion kthyes individual (dhe përfshin një anëtar të shërbimit profesional nëse vlerëson se ka nevojë). Mund të bëhet edhe si aktivitet sinkron që e bëjnë të gjithë nxënësit njëherësh gjatë orës, pas çka vijon diskutimi në grup.

Në vijat shënoi gjërat që të brengosin ose nga të cilat ke frikë:

1.....

2.....

3.....

4.....

5.....

Shqyrto termometrin më poshtë dhe për secilën nga gjërat e shënuara paraprakisht shëno se sa të brengosë/frikëson



Nuk më frikëson/brengos fare	Më frikëson/brengos	Më frikëson/brengos shumë Vetëm në këtë mendoj

Gjatë realizimit të aktivitetit si aktivitet sinkron, mësimdhënësi (ose anëtari i shërbimit profesional) sqaron se një nxënës mund të jetë shumë i frikësuar nga diçka që një tjetër nxënës nuk e frikëson fare. Sqaron se sa është e dobishme të flasim për qëndrimet tona. Prindërit, mësimdhënësit dhe miqtë janë këtu për të biseduar për atë me nxënësit. Kur flasim për atë nga çka kemi frikë, bëjmë plan që të ndihmojmë në tejkalimin e asaj frike ose ta ndërrojmë vendin e saj në termometrin e brengosjes.

*Përshtatur nga: https://www.centervention.com/coping-worry-fear/

Shembulli 3. Instruksione teknike, udhëzime, hapa për mësimdhënësit dhe ESARU administratorët e shkollave si të realizojnë orë të përbashkëta me nxënës dhe mësimdhënës të paraleleve të ndryshme dhe gjuhëve të ndryshme mësimore

Realizimi i orëve të përbashkëta me nxënës dhe mësimdhënës të paraleleve të ndryshme dhe gjuhëve të ndryshme mësimore mund të zbatohet përmes veglës Microsoft Teams e cila është pjesë e veglave të Platformës kombëtare. Të gjithë mësimdhënësit tashmë e përdorin veglën Microsoft Teams, por nëse nuk e keni shkarkuar në aparatin tuaj mund të qaseni deri te vegla edhe përmes përdorimit të shfletuesve të faqeve të internetit (Microsoft Edge, Mozila Firefox, Google Chrome, etj.) me atë që do të qaseni përmes linkut si vijon www.teams.microsoft.com



Foto 1.

MENAXHIM I PROFILEVE TË PËRDORUESVE

Secili mësimdhënës/nxënës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka adresë të ndarë zyrtare elektronike të përbërë prej inicialeve të përdoruesit dhe gjashtë shifrave (xx123456@schools.mk). Çdo adresë elektronike ka mundësinë e përdorimit e të gjitha veglave të Microsoft 365. Nëse mësimdhënësi/nxënësi ka problem gjatë hyrjes me emrin dhe fjalëkalimin e tij të përdorimit duhet t'i drejtohen **ESARU administratorëve** në shkollën e tyre.

Çdo **ESARU administrator** ka mundësi t'i resetojë fjalëkalimet e mësimdhënësve/nxënësve nga shkolla e tij dhe për këtë qëllim përdoret aplikacioni pass.schools.mk.



Foto 2.

Nevojitet që administratori të paralajmërohet në aplikacionin me adresën zyrtare elektronike të shkollës (ou-xxx-xxx@schools.mk) dhe në pjesën **menaxhment i përdoruesve** të përzgjedhë listën e **profileve të përdoruesve të mësimdhënësve** ose **listën e profileve të përdoruesve të nxënësve**. Nëse ESARU administratori ka problem me paralajmërimin në aplikacionin me adresën elektronike të shkollës, nevojitet të drejtohet deri te mbështetja e përdoruesve e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.



Foto 3.

Aplikacioni është i thjeshtë për përdorim ashtu që mundëson kërkim të lehtë të përdoruesve, gjegjësisht mundësi për përdorimin e filtrave në tabelë e gjithë kjo me qëllim që më shpejtë të gjendet mësimdhënësi/nxënësi i kërkuar për të cilin nevojitet të bëhet ndryshim i fjalëkalimit. Ashtu siç janë futur të dhënat e mësimdhënësve/nxënësve në ESARU sistemin, ashtu janë edhe të sinkronizuara të dhënat e njëjta në aplikacionin për menaxhimin e profileve të përdoruesve.

KRIJIM I ORËS/EKIPIT NË PAS APLIKACIONIN NGA ESARU ADMINISTRATORI

Secili ESARU administrator ka mundësinë të krijojë paralele/orë/ekip përmes pas aplikacionit. Paralelja e krijuar do të jetë e dukshme në Platformën kombëtare për mësim në distancë me atë që mësimdhënësi i caktuar do të ketë mundësi të shtojë materiale të dukshme për të gjithë pjesëmarrësit në ekipin dhe do ta rregullojë paralelen në mënyrë plotësuese.

Në vetë aplikacionin ka më shumë mënyra të krijimit të paraleleve, siç është paraqitur në foton numër 4 me klikim në **Lëndë zgjedhore dhe paralele** paraqiten mundësitë plotësuese për krijimin e paraleles/orës/ekipit, i cili në rastin tuaj nevojitet të përzgjidhet

Menaxhim i lëndëve zgjedhore



Foto 4.

Me përzgjedhjen e opsionit **Menaxhim të lëndëve zgjedhore** do të paraqitet dritare plotësuese, gjegjësisht formë përmes të cilës mund t'i vendosni të dhënat e nevojshme në mënyrë që të krijoni **paralele/orë/ekip.**



Foto 5.

Siç është paraqitur në Foton numër 5 në tabin **shkollë** tashmë gjendet shkolla juaj. Në tabin **objekt** e përzgjidhni shkollën tuaj, e nëse keni shkollë rajonale krijoni edhe paralele/orë/ekip për shkollën rajonale e përzgjidhni shkollën rajonale. Në mënyrë plotësuese e përzgjidhni **vitin/klasën** në të cilën do ta krijoni paralelen e re, e më pas e përzgjidhni lëndën. Pasi të përzgjidhni lëndën, nevojitet të përzgjidhni njërin prej mësimdhënësve që do të ligjërojnë në orën e përbashkët, në listën do të paraqiten të gjithë mësimdhënësit në shkollë të cilët në ESARU sistemin janë të lidhur me lëndën e përzgjedhur.

Pasi të plotësoni formën siç është paraqitur në foton numër 5 paraqitet propozim emër, gjegjësisht titull i paraleles/orës/ekipit të ri si për shembull **Lëndë-viti/klasë-grup-mësimdhënës**. Në këtë pjesë të formës ESARU administratori ka mundësi të bëjë

ndryshimin e titullit, por është me rëndësi emri i ri i paraleles/orës/ekipit të ketë mbi 20 karaktere dhe të mos përsëritet me lëndët e krijuara tashmë të rregullta. Nëse krijoni orë/ekip të përbashkët për gjuhën angleze, është e nevojshme që në titullin të theksoni se bëhet fjalë për paralele/orë/ekip të përbashkët, e gjithë kjo me qëllim që të mos ketë huti te mësimdhënësit/nxënësit, gjegjësisht dyfishim të lëndëve të rregullta. Pasi që titulli është tashmë i futur, nevojitet të klikoni në pullën **krijo paralele** dhe paralelja juaj do të jetë e krijuar. Nëse gabimisht është krijuar ndonjë paralele/orë/ekip zgjedhor mund ta fshini majtas nga emri i lëndës.

Pasi të krijohet paralelja/ora/ekipi në këtë shtesë për menaxhim, në afat prej 24 orëve do të paraqitet në PKMD-së, ku mësimdhënësi të cilit i është dhënë paralelja/ora/ekipi do të ketë mundësinë që në pjesën **pjesëmarrës** t'i shtojë të gjithë pjesëmarrësit, si dhe të menaxhojë me rolet e tyre. Meqë bëhet fjalë për orë të përbashkët mësimdhënësi të cilit i është dhënë paralelja duhet ta shtojë mësimdhënësin e dytë për orën e përbashkët si dhe të gjithë nxënësit që do të ndjekin mësimin në atë orë.

Mësimdhënësi i cili e ka rolin më të lartë në paralele/orë/ekip do të ketë nevojë t'i vendosë të gjitha adresat elektronike të nxënësve të cilët do të jenë të përfshirë në orën e përbashkët. Secili kujdestar i klasës e ka listën e adresave elektronike të nxënësve, por nëse ka nevojë siç është bërë e ditur edhe në pjesën për **menaxhim të profileve të përdoruesve**, ESARU administratori mund ta japë listën e adresave elektronike të nxënësve/mësimdhënësve.

*Të gjitha udhëzimet për të shtuar nxënës/mësimdhënës, bashkëngjitje të materialeve të PKMN-së mund t'i shkarkoni në linkun si vijon https://schools.mk/trening-materijali/

Pasi që gjithçka do të jetë e rregulluar në PKMD, paralelja/ora/ekipi i krijuar do të paraqitet edhe në veglën Microsoft Teams ku mësimdhënësi do të mund t'i rregullojë në mënyrë plotësuese rolet e pjesëmarrësve, mësimdhënësve, si dhe të shtojë bashkëpunëtorë, këshilltarë dhe shfrytëzuesit tjerë të cilët në një periudhë të caktuar do të duhet të jenë të pranishëm në orë.

*Të gjithë këshilltarët, bashkëpunëtorët që duhet të marrin pjesë në orë duhet të kenë adresë zyrtare elektronike (xx12345@schools.mk). Krijimi i adresës elektronike bëhet përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Rregullimi i orës në veglën Microsoft Teams është sqaruar në pjesën PRIVILEGJE PLOTËSUESE DHE RREGULLIME PËR ORËN

KRIJIMI I ORËS/EKIPIT NË MICROSOFT TEAMS NGA MËSIMDHËNËSI

Pasi që mësimdhënësi do të paralajmërojë në veglën Microsoft Teams krahas ekipeve tashmë të krijuara ka mundësi të krijojë ekip të ri, gjegjësisht të bashkojë dy paralele në një orë/ekip ose më shumë mësimdhënës dhe nxënës në një ekip.



Foto 6.

Siç është paraqitur në foton numër 6 në këndin e sipërm të djathtë gjendet opsioni **Join or create team,** me përzgjedhjen e **Join or create team** nevojitet të përzgjidhni **Create team.**



Foto 7.

Gjatë krijimit të ekipit, paraqitet një meny plotësuese, e paraqitur në foton numër 7 ku nevojitet të përzgjidhni **Class,** meqë krijoni orë të përbashkët**.**



Foto 8.

Në pjesën **Create your team** nevojitet të vendoset emri i lëndës, gjegjësisht ora e përbashkët (gjuhë angleze V 1 dhe V 2), ndërsa në mënyrë plotësuese opsionale mund të vendosni edhe përshkrim të orës.



Foto 9.

Gjatë krijimit të orës/ekipit, hapi i radhës ofron mundësi që të shtohen nxënësit për të cilët është e nevojshme ta ndjekin mësimin në atë orë. Nxënësit mund të vendosen në tabin **Students** me vendosjen e emrit dhe mbiemrit ose me vendosjen e adresës zyrtare elektronike të nxënësit.

Meqë secilit nxënës nga kujdestari i klasës i është dhënë adresa elektronike, mësimdhënësi që do ta krijojë orën mund të marrë listën e adresave elektronike të nxënësve dhe t'i shtojë gjatë krijimit të orës së përbashkët. Secila adresë elektronike e nxënësve përbëhet prej

inicialeve të nxënësit dhe gjashtë shifrave, ndërsa domeini zyrtar është @schools.mk për shembull xx123456@schools.mk

Procesi i shtimit të mësimdhënësve në orën/ekipin është në mënyrë të njëjtë si edhe për nxënësit, me atë që mësimdhënësit shtohen në tabin **Teachers**. Si edhe te nxënësit, të gjithë mësimdhënësit kanë adresa zyrtare elektronike që përbëhen prej inicialeve të mësimdhënësit gjashtë shifra, ndërsa domeini zyrtar është @schools.mk për shembull xx123456@schools.mk



Foto 10.

Nëse nevojitet të shtohen në mënyrë plotësuese nxënës/mësimdhënës, në orën/ekipin tashmë të krijuar keni mundësi që ta rregulloni edhe në mënyrë plotësuese orën, gjegjësisht ta plotësoni listën e nxënësve/mësimdhënësve.

Nëse nga ana e majtë përzgjidhni menynë **Teams**, do të keni pasqyrën e të gjitha orëve/ekipeve tuaja, gjegjësisht të gjitha lëndëve që janë krijuar paraprakisht, në rastin tuaj ju tashmë i keni ndarë ose krijuar lëndët e rregullta për paralelen tuaj. Çdo orë/ekip në këndin e sipërm të djathtë ka opsion që pasi ta klikoni keni mundësinë e përzgjedhjes së rregullimit të orës së krijuar, për këtë qëllim nevojitet nga menyja të përzgjidhni **Manage teams**



Foto 11



Foto 12.

Në rastin tuaj të gjithë nxënësit do të jenë pjesëmarrës (member), e meqë ora/ekipi do të ketë dy mësimdhënës, dy mësimdhënës do të kenë rolin e **Owner-it**, me atë që do të mund të shtojnë në çdo kohë nxënës/mësimdhënës dhe kështilltarë për mbështetje mentoruese që do të ishin të pranishëm në orë. Mësimdhënësi që e ka rolin **Owner** ka mundësi ta ndryshojë rolin e përdoruesve të tjerë.

*Çdo orë/ekip i krijuar përmes Microsoft Teams do të jetë i dukshëm vetëm në veglën Microsoft Teams, nëse keni nevojë për bashkëngjitje të materialeve, detyrave të shtëpisë dhe ngjashëm nevojitet që krijimi i orës/ekipit të bëhet nga ESARU administratori.

CAKTIMI I ORËS

Pasi është krijuar ora juaj e përbashkët me nxënës dhe mësimdhënës të ndarë nga gjuhët e ndryshme mësimore, tashmë keni mundësi ta caktoni orën. Ora mund të thirret në momentin e njëjtë ose nga ana tjetër të caktohet në kohë përkatëse, në përputhje me orarin në shkollë. Siç është treguar në foton numër 13 me klikim në vetë orën/ekipin në këndin e sipërm të djathtë gjendet opsioni **Meet,** ndërsa me klikim në shigjetën pranë opsionit do t'ju shfaqen opsionet për caktimin e orës në momentin e njëjtë **Meet now** ose ta caktoni në përputhje me orarin **Schedule a meeting**.



Foto 13.

Nëse e përzgjidhni opsionin **Schedule a meeting** nevojitet të përkufizoni takimin/orën. Siç është parashikuar në foton numër 12 nevojitet ta vendosni emrin e orës, datën, orën, kohëzgjatjen e orës. Nëse ora përsëritet çdo javë në terminin e njëjtë nevojitet të klikoni në **repeat,** në mënyrë automatike do të vendoset në kalendarin për çdo javë të ardhshme. Video

Nëse në orën në mënyrë plotësuese nevojitet të jetë i pranishëm këshilltari nga BZHA-ja dhe QAPT-ja në rast të tillë e shtoni edhe adresën elektronike të këshilltarit në pjesën **Add required attendees.** Meqë nxënësit dhe mësimdhënësit janë vendosur në orë të përbashkët gjatë vetë krijimit të ekipit, e njëjta do të shfaqet në kalendarin te të gjithë pjesëmarrësit, ndërsa në mënyrë plotësuese do të informohen edhe në adresat e tyre elektronike.



Foto 14.

PRIVILEGJE PLOTËSUESE DHE RREGULLIME TË ORËS

Pasi që ora është caktuar tashmë nga ana juaj dhe e vendosur në kalendarin e të gjithë pjesëmarrësve, ju keni për detyrë që në mënyrë plotësuese t'i rregulloni privilegjet e nxënësve në orë. Në kalendarin tuaj duhet ta shënoni takimin dhe të klikoni në **Edit** siç është paraqitur në foton numër 14. Video



Foto 15.

Pasi të klikoni në **Edit**, shfaqet një dritare e re ku ju shfaqet opsioni **Meetingoptions,** ndërsa për të pasur qasje deri te rregullimet plotësuese nevojitet të klikoni me klik të djathtë në **Meeting options** dhe të përzgjidhni **Open link** në atë mënyrë që do të paraqiten, rregullimi plotësuese për takimin.



Foto 16.

Siç është paraqitur në foton numër 17, me rregullimin e parë keni mundësinë të përzgjidhni nëse pjesëmarrësit do të mund të hyjnë në orë pa lejen tuaj ose gjatë hyrjes së secilit nxënës në orë ju të lejoni praninë e tyre. Nëse në opsionin **Always let callers bypassthe lobby** përzgjidhni **NO**, asnjëri nga të pranishmit nuk do të mund të hyjë në orë pa lejen tuaj.



Foto 17.

Me rregullimin e dytë, gjegjësisht **Announce when callers join or leave** keni mundësinë të merrni lajmërime derisa zgjatë ora kush ka hyrë/dalë nga ora. Nëse përzgjidhni **YES** do të keni lajmërime për secilin nxënës.

Me rregullimin e tretë gjegjësisht **Who can present**, nevojitet të përzgjidhni **Only me,** me atë që ju si mësimdhënës do të keni opsion që secilit prej nxënësve ose mësimdhënësve të tjerë t'ua jepni rolin e prezantuesit derisa zgjatë ora, nëse e përzgjidhni opsionin **Everyone in organization** secili nxënës do të mund ta ndajë ekranin e tij. Në rastin tuaj ju do të duhet t'ia ndani rolin e prezantuesit edhe mësimdhënësit të dytë meqë bëhet fjalë për orë të përbashkët. Në mënyrë plotësuese ndarja e rolit të prezantuesit bëhet me link të ndarë në emrin e mësimdhënësit, gjegjësisht siç është paraqitur në foton numër 18.



Foto 18.

Rregullimi i katërt është shumë i rëndësishëm në rastin tuaj meqë shpesh ndodhë që të gjithë nxënësit në orë t'i kenë kyçur mikrofonat e tyre ose nga ana tjetër, t'i shkyçin mikrofonat e njëri-tjetrit po madje edhe të mësimdhënësve me çka vini në situatë të keni probleme teknike gjatë mbajtjes së orës. Nëse klikoni te opsioni **Allow attendees to unmute përzgjidhni Yes,** atëherë të gjithë nxënësit në orë do të kenë leje që ta shkyçin/kyçin mikrofonin e të gjithë nxënësve dhe mësimdhënësve. Në rastin tonë nevojitet të përzgjidhni **No.**

EVIDENCË PËR PRANI TË NXËNËSVE NË ORË DHE EVIDENTIM NË DITAR

Meqë bëhet fjalë për orë në distancë do t'ju nevojitet t'i evidentoni nxënësit e pranishëm në mënyrë që të mund t'i evidentoni edhe në ditarët tuaj. Shpesh ndodhë që nxënësit vetëm të lajmërohen, gjegjësisht të hyjnë në orë dhe për një kohë të shkurtër ta braktisin orën. Me veglën Microsoft Teams keni mundësi derisa zgjatë ora ose pas përfundimit të orës në formatin **.xls** të shkarkoni listën e të pranishmëve. Lista e të pranishmëve përmban emrin dhe mbiemrin e nxënësve, si dhe në sa ora janë lajmëruar/çlajmëruar nga ora e

mësimit. Listën e të pranishmëve mund ta shkarkoni me hapat e përshkruar në foton numër 19. Video



Foto 19.

Me këtë listë ju mund ta evidentoni praninë e nxënësve në orë, gjegjësisht secili mësimdhënës t'i evidentojë nxënësit në ditarin e tij.

Meqë bëhet fjalë për orë të përbashkët secili mësimdhënës në ditarin e tij ka mundësi ta vendosë orën e tij, ashtu që në ditarin elektronik keni fushë plotësuese për vendosjen e shënimit ku do të mund t'i vendosni vërejtjet nga ora, gjegjësisht të plotësoni se bëhet fjalë për orë të përbashkët.